

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXV, nr. 8134
E premte, 5 shtator 2025
Çmimi 0.50 €

**Roja që u bë prokuror
i keqtrajtoi krerët e UÇK-së,
Thaçi e krahason Specialen
me regjimin e Putinit** I FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION

**DEMOKRACIA LOKALE DHE
ZHVILLIMI: A DUHET KOSOVA
TA NDRYSHOJË MËNYRËN E
ZGJEDHJES SË KRYETARËVE
TË KOMUNAVE?** F.5

Shkruan:
Nazmi JUSUFI



AKTUALE

**2 205 VIKTIMA NGA TËRMETI
NË AFGANISTAN** F.2

**KOSOVA NGRE AKTAKUZË PËR
SPIUNAZH NDAJ ISH-PUNONJËSES
SERBE TË OSBE-së** F.7

EKONOMI



**KRYEPROKURORI I SHTETIT DHE
DREJTORI I ATK-SË DISKUTOJNË
PËR THELLIMIN E BASHKËPUNIMIT** F.8

**FUQIZOHEN GRATË SIPËRMARRËSE
TË AGROBIZNESIT NË KOSOVË** F.8

SPORT



DITA E 'DARDANËVE' F.10

PAS TËRHEQJES SË SHORTIT, LIDERËT E PARTIVE POLITIKE THONË SE KANË EKETET MË TË MIRA PËR QEVERISJEN LOKALE



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka tërhequr shortin për renditjen e subjekteve politike në fletëvotimin për zgjedhjet lokale të 12 tetorit. Lëvizja Vetëvendosje do ta ketë numrin 105,

Partia Demokratike e Kosovës 191, Lidhja Demokratike e Kosovës 113, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës 174, Nisma Socialdemokrate 186, Partia Socialdemokrate 149, Lista Guxo

118 dhe Lista Serbe 170. Pas tërheqjes së shortit, liderët e partive politike kanë reaguar, duke theksuar se numrat e tyre mbartin ekipin më të mirë për ta udhëhequr qeverisjen lokale

**LV-ja PRITET TA
RIKONFIRMOJË TË
DIELËN KURTIN
MANDATAR PËR
KRYEMINISTËR** F.5



**MARRËVESHJA
E UASHINGTONIT
E 4 SHTATORIT
2020: MUNDËSI
E HUMBUR** F.3

SHKRUAN: AVDULLAH HOTI



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVIÇË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË



**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency

Endrit Shaqiri
+38344685122

Internet Website,
Marketing...

ROJA QË U BË PROKUROR I KEQTRAJTOI KRERËT E UÇK-së, THAÇI E KRAHASON SPECIALEN ME REGJIMIN E PUTINIT

PRISHTINË, 4 SHTATOR - John Devaney ka qenë gardian i thjeshtë në Qendrën e Paraburgimit në Scheveningen, ku Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi po qëndrojnë prej afër pesë vjetësh, për të cilin u raportua ekskluzivisht në “Kronika e Hagës” të “Info Magazine” para pak javësh. “Klan Kosova” sjell hollësi se si karriera e këtij prokurori mori përpjetën brenda pak kohësh. Ai nga roje burgu, u bë hetues. Më tej u gradua në zëvendësshef, e krejt vonë shef i Qendrës së Paraburgimit. Krejt këto më së miri i di katërshja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, meqë prijësi i tyre, Hashim Thaçi, tregoi para Trupit Gjykues në seancën e 27 marsit, kur u dëgjua dëshmitari i fundit, pasi kërkoi një bisedë urgjente me avokatin e tij që ta kërkonte fjalën nga kryetari i Trupit Gjykues, Charles Smith. Gjyqtarit amerikan dhe tre gjyqtarëve të tjerë të Panelit, Thaçi u tregoi se si ish-gardiani, tash prokuror, i ka keqtrajtuar e kërcënuar fizikisht krerët e UÇK-së.

“Klan Kosova” sjell hollësi të deklarimit të Hashim Thaçi nga seanca në fjalë

Hashim Thaçi: Kjo Gjykatë është e Kosovës. E ka themelua Kuvendi i Kosovës me punu sipas Kushtetutës dhe ligjeve të Kosovës dhe besoj që kështu dhe do të përmbyllet ky proces. Por në të njëjtën kohë shqetësimet që i kemi kaluar në këto katër vite e gjysmë këtu, me të njëjtën periudhë kohore, në të cilën sot ballafaqohemi me Prokurorin përballë nesh, dëshiroj të shpreh shqetësim



dhe të jeni të informuar dhe ju si Kryegjyqtar dhe në të njëjtën kohë si Panel.

Hashim Thaçi: U çuditëm sot shumë kur dhe u befasova kur sot përballë nesh u shfaq zotëriu në fjalë. Emrin nuk ia di as mbiemrin dhe s’është me rëndësi, që në qendrën e paraburgimit kur kemi ardhur fillimisht dhe për disa vite, është paraqitur si roje burgu, pastaj si hetues pranë qendrës së paraburgimit, pastaj si shef - si zëvendësshef i qendrës së paraburgimit dhe nganjëherë dhe shef i qendrës së paraburgimit. Për të gjitha këto që flas ekzistojnë faktet dhe dëshmitarë. I nderuar Gjykatës, zotëriu në fjalë - z. Prokuror sot,

dje roje burgu - [REDAKTUAR]

Hashim Thaçi: E ne, të katër që jemi të akuzuar në procesin numër 6, as cigare s’përdorim. Okej. Personalisht ka kryer kontrolle, Prokurori aktual [REDAKTUAR] Në raste të caktuara, i nderuari Kryetar i Gjykatës, të nderuar Panel Gjykatës, ka kryer fyerje dhe kërcënime dhe fizike ndaj ne të akuzuarve. Na ka fyer dhe ka kryer edhe kërcënime fizike Prokurori që është sot përballë nesh. Nga praktikat e zotëriut, [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe të tjerëve edhe ma gjatë.

Gjykata i redaktoi krejt keqtrajtimet, por jo edhe një krahasim që e barazon

Specialen me regjimin e Rusisë së Vladimir Putinit.

Hashim Thaçi: Edhe kjo praktikë mu më shqetëson kur sot e shoh këtë zotëri, dje paraqitej si roje burgu dhe sot Prokuror, një praktikë e tillë as ndaj disidentit rus Navalny nuk është praktiku ku mbas 20 ditësh iu kanë ndalu, kanë reagu të gjithë.

Ish-presidenti vë në pikëpyetje sistemin e shpejtë të gradimit brenda ZPS-së.

Hashim Thaçi: Dhe unë sot befasohem dhe çuditëm kur shoh këtë. Ndoshta është në procedurë speciale e gradimit në SPO, por nuk ndihemi rehat

dhe nuk ndihemi të respektuar dhe të trajtuar denjësisht as në kuptimin legal, jo drejt, kur shohim përballë një njeri që dje paraqitej roje burgu dhe sot është prokuror në Dhomat e Specializuara të Kosovës.

Atë ditë Prokurori e kishte pranuar angazhimin e tij të mëparshëm.

Kjo është biseda e zhvilluar mes tij dhe Smith.

John Devaney, prokuror: I nderuar Gjykatës, është e saktë që unë kam punuar në njësinë e menaxhimit të objektit të paraburgimit para disa vjetësh. Nuk më kujtohet që t’i kem [REDAKTUAR].

Charles Smith, kryetar i Trupit Gjykues: Sa vjet ka?

John Devaney, prokuror: E kam shkëputur marrëdhënien e punës prej aty në fund të vitit 2022. Dhe kam dhe një [REDAKTUAR] e cila është e nënshkruar lidhur me këtë.

Charles Smith, kryetar i Trupit Gjykues: Problemi është që nuk duan që të vijnë me procesin. Kështu që do t’ju kërkoj që t’i përgjigjeni kësaj.

John Devaney, prokuror: Një çast, i nderuar Gjykatës. [Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]. I nderuar Gjykatës, nuk kam argumente materiale për të bërë. Do të them vetëm që - mund të them vetëm që znj. Iodice është e gatshme që të marrë rolin tim për të trajtuar ndonjë shqetësim të Mbrojtjes.

2 205 viktima nga tërmeti në Afganistan

KUNAR, 4 SHTATOR - Qindra trupa të pajetë janë nxjerrë nga shtëpitë e rrënuara si pasojë e tërmetit të fuqishëm në Afganistan javën e kaluar, duke e çuar numrin e përgjithshëm të të vdekurve në mbi 2 200, tha të enjten një zëdhënës i qeverisë talibane. Tërmeti 6 ballësh goditi disa provinca malore në lindje të vendit të dielën në mbrëmje, duke rrafshuar fshatra dhe duke zënë njerëz nën rrënoja. Shumica e viktimave janë regjistruar në Kunar, ku shumë banorë jetojnë në lugina të

pjerrëta lumenjsh, të ndara nga male të larta. Zëdhënësi i talibanëve, Hamdullah Fitrat, i cili njoftoi për shifrën e përditësuar prej 2 205 viktimash, tha se përpjekjet për kërkim dhe shpëtim po vazhdojnë. “Janë ngritur shatorë për njerëzit dhe po shpërndahen ndihma të para dhe furnizime emergjente”, tha ai. Tereni i vështirë po ua bënë më të zorshme punën ekipeve për shpëtim. Autoritetet talibane kanë përdorur helikopterë dhe kanë dërguar



ushtarë nga ajri për t’i ndihmuar të mbijetuarit. Punonjësit e ndihmës thonë se detyrohen të ecin me orë të tëra për të arritur në fshatrat e bllokuara nga rrëshqitjet e dheut dhe shembja e shkëmbinjve.

Shkurtimet në financim po ndikojnë në reagimin ndaj krizës. Këshilli Norvegjez për Refugjatët tha se ka më pak se 450 punonjës në Afganistan, ndërsa në vitin 2023 - kur ndodhi tërmeti i fundit i madh në vend - kishte 1 100. Këshilli ka vetëm një magazinë në dispozicion dhe asnjë rezervë emergjente. “Do të duhet të blejmë artikuj sapo të sigurojmë fonde, por kjo mund të marrë javë të tëra dhe njerëzit kanë nevojë tani”, tha Maisam Shafiey, këshilltar

për komunikim i këshillit në Afganistan. “Ne kemi vetëm 100 000 dollarë për t’i mbështetur përpjekjet e reagimit emergjent. Kjo lë një boshllëk të menjëhershëm prej 1.9 milion dollarësh”, shtoi ai. Organizatat humanitare e kanë quajtur këtë fatkeqësi krizë brenda krizës. Afganistani tashmë po përballlet me pasojat e ndryshimeve klimatike, veçanërisht thatësisirën, me ekonominë të dobët dhe kthimin e rreth dy milionë afganëve nga vendet fqinje.

MARRËVESHJA E UASHINGTONIT E 4 SHTATORIT 2020: MUNDËSI E HUMBUR



Shkruan: Avdullah HOTI

Sot bëhen pesë vjet nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Uashingtonit, një arritje historike për Kosovën që krijonte mundësi unike për: (1) fuqizimin e partneritetit strategjik mes Kosovës dhe ShBA-së, si dhe (2) vendosjen e Kosovës në qendër të zhvillimeve ekonomike në rajon përmes projekteve madhore infrastrukturore. Po të zbatoheshin projektet e mëdha infrastrukturore të përfshira në këtë marrëveshje, Kosova sot do të merrte rolin e saj si nyje rrugore, hekurudhore dhe energjetike (përmes gazit) në rajon dhe përtej, me Fushë-Kosovën si port i thatë tregtar që do të lidhte portet e Durrësit dhe të Selanikut, për të vazhduar në veri për Evropën Qendrore. Në aspektin politik, marrëveshja solli njohjen nga Izraeli, duke e thyer bllokadën disa-vjeçare të mungesës së njohjeve dhe duke e avancuar subjektivitetin ndërkombëtar të Kosovës. Për fatin e keq të Kosovës dhe të

secilit qytetar, marrëveshja u neglizhua nga institucionet e Kosovës të dala nga zgjedhjet e vitit 2021. Kur u nënshkrua kjo marrëveshje, u kritikua ashpër nga opozita e atëhershme. Sot, pas pesë vitesh, të gjithë pa përjashtim janë të bindur për rëndësinë e saj strategjike, përfshirë ata që e cilësonin si tradhti kombëtare. Çfarë është realizuar në muajt shtator 2020 - mars 2021 në Qeverinë Hoti? Menjëherë pas nënshkrimit të marrëveshjes, Qeveria e Kosovës e ka miratuar planin e zbatimit. Gjatë periudhës së shkurtër të Qeverisë Hoti, janë realizuar disa pika, e disa të tjera kanë nisur së zbatuari: 1. Ministria e Infrastrukturës ka diskutuar gjerësisht me DFC (dhe BE) për këto projekte: vazhdimin e autostradës për Merdarë; lidhjen e autostradës për Durrës me autostradat për Shkup, Gjilan dhe Luginë të Preshevës përmes segmentit Shtime-Duhël;

studimin e para-fizibilitetit për hekurudhën për Durrës dhe projekte të tjera. 2. Ministria e Brendshme ka funksionalizuar pikën kufitare në Merdarë. 3. Ministria e Arsimit ka bërë përgatitjet për takimin e Qendrave NARIC Kosova dhe NARIC Serbia për njohjen reciproke të diplomave. 4. Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit ka punuar me ekspertët amerikanë në studimin e fizibilitetit për Liqenin e Ujmanit, i cili është finalizuar në qeverinë pasuese. 5. Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, KOSTT dhe ZRRE kanë miratuar këto projekte për diversifikimin e energjisë në kuadër të MCC-së: gazsjellësi Kosovë-Maqedoni e Veriut; rrjeti i furnizimit me gaz në Kosovë; zgjerimi i ngrohjes qendrore; energjia e ripërtëritshme; mbështetja e konsumatorëve të energjisë që vetë e prodhojnë energjinë; investime në rrjetin e

shpërndarjes së energjisë në rajonin e Podujevës, Malishevës dhe disa rajoneve të tjera. 6. Më 23 tetor 2020, me Nënsekretarin për Ekonomi, Energji dhe Ambient të ShBA-ve, është nënshkruar memorandumi për sistemin 5G. 7. Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për sigurinë e pajisjeve të teknologjisë 5G, në përputhje me standardet e vendosura nga ShBA. 8. Në fushën e komunikacionit ajror, Ministria e Brendshme ka instaluar pajisjet që i përmbushin standardet ndërkombëtare për luftën kundër terrorizmit, sipas Rezolutave të OKB-së 2178 dhe 2396. Ministri i Brendshëm e ka nënshkruar Udhëzimin Administrativ dhe janë testuar pajisjet për sigurinë e të dhënave. 9. Në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të lirive fetare është përgatitur projektligji i ri dhe është krijuar grupi ndërministror

për analizimin e gjendjes sa i përket pasurisë së komunitetit hebre, e cila ende nuk është trashëguar apo kërkuar. 10. Për personat e pagjetur, janë marrë zotime për të punuar në gërmime vlerësuese në disa lokacione, për të shqyrtuar databazat e organizatave ndërkombëtare dhe për qasje në informacione në Serbi. 11. Janë marrë veprime për të shpallur si organizata terroriste ato që konsiderohen të tilla nga ShBA. 12. Më 21 shtator 2020, është nënshkruar deklarata e përbashkët me DFC-në për të përshpejtuar nënshkrimin e Marrëveshjes për Nxitje të Investimeve në mes të Kosovës dhe ShBA-ve. 13. Rrjedhimisht, më 31 dhjetor 2020, në afat rekord, është nënshkruar Marrëveshja për Nxitje të Investimeve në mes të Kosovës dhe ShBA-ve. 14. Janë vendosur marrëdhëniet diplomatike me Izraelin.

GIS: ShBA-ja mund ta prioritizojë Bosnjën para Kosovës dhe Serbisë

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Një raport i Geopolitical Intelligence Services (GIS) analizon skenarët e mundshëm të diplomacisë amerikane në Ballkanin Perëndimor, duke theksuar se Shtetet e Bashkuara mund ta prioritizojnë Bosnjë-Hercegovinën para Kosovës dhe Serbisë. “Nga të dy çështjet, aktualisht e ardhmja e Bosnjë-Hercegovinës duket më urgjente. Çdo zgjidhje për këtë vend do të duhej t’i merrte parasysh interesat e Serbisë dhe Kroacisë të cilat e shohin veten si mbrojtëse të komunitetit serb dhe kroat”.

James Jay Carafano, ekspert i politikës së jashtme dhe sigurisë kombëtare, vlerëson se synimi i presidentit amerikan Donald Trump për ta luajtur rolin e paqebërësit mund të çojë drejt iniciativave të reja rajonale amerikane në Ballkanin Perëndimor, raporton “albanianpost”, për shkak të ndikimit të jashtëm i cili vazhdon të jetë një pengesë e madhe për stabilitetin në rajon. Rusia synon ta pengojë integrimin e vendeve ballkanike në NATO dhe BE, duke shfrytëzuar ndarjet etnike, fetare e politike. Kina,

gjithashtu, bën përpjekje ta zgjerojë pranimin e saj, veçanërisht përmes investimeve infrastrukturore. “Shtetet e Bashkuara nuk mund t’i ruajnë interesat e tyre nëse Kina dhe Rusia arrijnë të krijojnë një sferë ndikimi të zgjeruar dhe dominuese në Evropën Perëndimore. Një stabilitet më i madh në Ballkanin Perëndimor do të hiqte një pikë të mundshme konflikti në krahun lindor të NATO-s”, konsideron autori i analizës së GIS. Ai nënvizon se, megjithëse një ndryshim dramatik i



politikës amerikane në rajon mund t’i transformojë përpjekjet në planin afatgjatë, në planin

afatshkurtër kjo s’ka gjasa t’i adresojë problemet e rajonit - ndarjet politike, etnike dhe situatën e keqe ekonomike.



PAS TËRHEQJES SË SHORTIT, LIDERËT E PARTIVE POLITIKE THONË SE KANË EKIPIET MË TË MIRA PËR QEVERISJEN LOKALE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka tërhequr shortin për renditjen e subjekteve politike në fletëvotimin për zgjedhjet lokale të 12 tetorit. Lëvizja Vetëvendosje do ta ketë numrin 105, Partia Demokratike e Kosovës 191, Lidhja Demokratike e Kosovës 113, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës 174, Nisma Socialdemokrate 186, Partia Socialdemokrate 149, Lista Guxo 118 dhe Lista Serbe 170. Pas tërheqjes së shortit, liderët e partive politike kanë reaguar, duke theksuar se numrat e tyre mbartin ekipin më të mirë për ta udhëhequr qeverisjen lokale

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka hedhur të enjten shortin për renditjen e subjekteve politike në fletëvotimin për zgjedhjet lokale të 12 tetorit. Në këto zgjedhje garojnë 5 626 kandidatë, prej tyre 206 janë kandidatë për kryetarë komunash, të tjerët për ulëse në kuvende komunale. Në zgjedhjet lokale për 38 komuna janë certifikuar 93 subjekte - 32 parti politike, 32 iniciativa qytetare, dy koalicionë dhe 27 kandidatë të pavarur. Kryetari i KQZ-së, Kreshnik Radoniqi, ka thënë se ky hap tregon se procesi përgatitor ka

hyrë në fazën përfundimtare. "Zgjedhjet janë themeli i një demokracie, pasi përmes tyre qytetarët shprehin vullnetin politik duke zgjedhur përfaqësuesit në nivelin qendror dhe lokal", ka thënë ai. Radoniqi ka bërë me dije se prej 17 shtatorit do të nisë votimi me postë për mbi 260 mijë shtetas kosovarë të regjistruar që jetojnë jashtë territorit të Kosovës. Subjektet e certifikuar janë renditur me numra prej 100 deri më 192. Sipas shortit të hedhur, Lëvizja Vetëvendosje do të garojë me numrin 105, Partia Demokratike e Kosovës 191, Lidhja Demokratike e Kosovës 113, Aleanca për Ardhmërinë e

Kosovës 174, Guxo 118, Nisma Socialdemokrate 186, PSD-ja 149, Alternativa 103, Ramiz Lladrovci 101, Aleanca Kosova e Re 122, Lista Serbe 170, Partia Demokratike e Ashkalinjëve 180, Iniciativa e re Demokratike e Kosovës 162 dhe Partia Liberale Egjiptiane me numër 137. Kryeministri në detyrë, kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka reaguar pas shortit, duke e lidhur këtë numër me fitoret e subjektit që ai udhëheq. "105, numri i fitoreve të radhës, i besimit të qytetarëve dhe shërbimit ndaj tyre", ka shkruar Kurti në "Facebook". Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se me numrin 191, PDK-ja hyn në

zgjedhjet lokale për t'ua sjellë komunave të Kosovës modelin e qeverisjes 'MaMirë' - me punë, përgjegjësi dhe vizion. "Me kandidatët më të mirë për kryetarë, këshilltarët më të përgatitur komunalë dhe programin më zhvillimor, jemi gati për fitore. Bashkë, përpara!", ka thënë Krasniqi. Pas hedhjes së shortit ka reaguar edhe kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, i cili ka thënë se 12 tetori do të jetë festë për këtë parti. "Ky është numri ynë. 12 tetori është festa jonë. LDK-ja përgjithmonë!", ka shkruar Abdixhiku në "Facebook". Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se më 12 tetor qytetarët do ta kenë mundësinë të zgjedhin njerëz të dëshmuar në komuna për fitore të reja. "Aleanca gjithmonë ka treguar se është shembull, shembull për të gjithë, sepse për ne flet puna, jo premtimet. Ky është angazhimi ynë: punë, jo premtime, dhe këtë e kemi vërtetuar kudo ku kemi marrë përgjegjësi", ka deklaruar Haradinaj. Pas hedhjes së shortit ka reaguar

edhe kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, i cili ka theksuar se Kosova është amaneti ynë, përkushtim i përjetshëm. "Me numrin 186, Nisma Socialdemokrate hyn në këto zgjedhje lokale me besim të plotë dhe vendosmërinë për të qëndruar pranë qytetarëve, për të mbrojtur vlerat tona dhe për të sjellë qeverisje që matet me vepra, jo me fjalë. 'Përjetë Kosova' është besimi ynë i palëkundur, është përkushtimi i gjeneratave që e ndërtuan këtë vend me gjak, mund dhe sakrificë. Është zotimi ynë që kudo, në çdo qytet e në çdo komunë, do të jemi zëri i qytetarëve. Është zotimi ynë që të mbesim gjithmonë në shërbim të Kosovës dhe qytetarëve të saj. Ne do të vazhdojmë përjetësisht angazhimin tonë për Kosovën, për dinjitetin e qytetarëve tanë dhe për të ardhmen euro-atlantike që e meriton vendi ynë", ka thënë Limaj. "Voto për komunën tënde" është motoja me të cilën do të organizohen zgjedhjet e 12 tetorit. Kosova i ka mbajtur zgjedhjet e fundit lokale në tetor të vitit 2021.

DEMOKRACIA LOKALE DHE ZHVILLIMI: A DUHET KOSOVA TA NDRYSHOJË MËNYRËN E ZGJEDHJES SË KRYETARËVE TË KOMUNAVE?



Shkruan: Nazmi JUSUFI

Zgjedhja e kryetarëve të komunave nuk është thjesht një proces politik; ajo reflekton edhe mënyrën se si funksionon administrata publike dhe si menaxhohen burimet në nivel lokal. Për më tepër, mënyra e zgjedhjes së kryetarit ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi zhvillimin ekonomik dhe social të komunës, cilësinë e shërbimeve publike dhe besimin e

qytetarëve në institucionet vendore.

Në Evropë praktikat ndryshojnë ndjeshëm. Ekzistojnë dy modele kryesore të zgjedhjeve të kryetarëve të komunës (kryebashkiakëve) zgjedhja direkte nga qytetarët dhe zgjedhja indirekte nga këshillat lokalë. Modeli direkt, i përdorur në Kosovë, Shqipëri, Itali, Poloni dhe disa vende të tjera, i jep qytetarit fuqinë për të zgjedhur drejtpërdrejt përfaqësuesin e tij më të afërt. Ky sistem krijon legjitimitet të fortë demokratik, transparencë dhe përgjegjësi të drejtpërdrejtë përpara qytetarëve. Ai gjithashtu stimulon lidhshipin lokal të përgjegjshëm dhe nxit një marrëdhënie të qartë midis votës dhe performancës së kryetarit. Megjithatë, kjo qasje nuk është e lirë nga rreziqet:

personalizimi i pushtetit, tensionet me këshillin komunal dhe rreziku i populizmit janë sfida reale, sidomos në shoqëritë ku institucionet mbikëqyrëse nuk janë të konsoliduara.

Në modelin indirekt, të përdorur në vende si Holanda, Belgjika, Danimarka, Suedia dhe pjesërisht Zvicra, kryetari zgjidhet ose emërohet nga këshilli lokal apo nga qeveria qendrore. Ky model favorizon stabilitetin politik dhe profesionalizmin administrativ. Ai zvogëlon ndikimin e fushatave populiste dhe i jep rëndësi përvojës menaxheriale të kandidatëve. Megjithatë, një nga mangësitë më të mëdha është deficit demokratik: qytetari nuk ka ndikim të drejtpërdrejtë dhe shpesh e percepton kryetarin si përfaqësues të partive, më

shumë sesa të popullit. Kjo mund të dobësojë lidhjen midis qytetarëve dhe pushtetit lokal dhe të ulë llogaridhënien.

Për Kosovën, ku demokracia lokale është ende në konsolidim dhe besimi te partitë politike është relativisht i ulët, ruajtja e modelit të zgjedhjes direkte mbetet strategjia më e përshtatshme. Zgjedhja direkte i jep qytetarëve ndjesinë e pjesëmarrjes aktive dhe afërsinë me institucionet vendore. Megjithatë, për të maksimizuar përfitimet e këtij modeli, duhet punuar më shumë në forcimin e transparencës së vendimmarrjes, menaxhimin profesional të buxheteve komunale dhe mekanizmat e llogaridhënies, duke përfshirë kontrollin e rregullt të performancës së kryetarëve dhe bashkëpunimin me

institucionet qendrore.

Nga perspektiva e përvojës në administratën publike dhe krahasimi me zhvillimet në BE, është e qartë se modeli i zgjedhjes së kryetarëve duhet të balancojë legjitimitetin demokratik me efikasitetin administrativ. Në vendet e BE-së, kombinimi i përgjegjësisë politike dhe profesionalizmit administrativ është çelësi i suksesit të qeverisjes vendore dhe zhvillimit lokal të qëndrueshëm. Për Kosovën, kjo do të thotë ruajtje e modelit direkt, por me reforma të synuara në kapacitetin administrativ, transparencë dhe llogaridhënie, që do të përmirësonin menaxhimin e burimeve dhe cilësinë e shërbimeve publike, duke e bërë pushtetin lokal më të besueshëm dhe më efikas.

LV-JA PRITET TA RIKONFIRMOJË TË DIELËN KURTIN MANDATAR PËR KRYEMINISTËR

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Fituesja e zgjedhjeve parlamentare të shkurtit, Lëvizja Vetëvendosje (LV), pritet ta rikonfirmojë Albin Kurtin mandatar për kryeministër të Kosovës në fundjavë, saktësisht një javë pasi kryetari i Kuvendit, Dimal Basha, e shpalli njëanshëm të përfunduar konstituimin e organit ligjvënës.

Partitë ish-opozitare nuk pajtohen se Kuvendi është konstituuar, pasi ende nuk është zgjedhur nënkryetari i pestë dhe i fundit i Kuvendit nga komuniteti joshumicë serb. Por, LV-ja ngul këmbë se duhet të ecet përpara me formimin e institucioneve, prandaj edhe do ta mbajë mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm të partisë për ta zgjedhur mandatarin për kryeministër.

Këtë e konfirmoi për “Radio Evropa e Lirë” zëdhënësi i LV-së, Arlind Manxhuka, i cili tha se mbledhja do të mbahet të dielën e 7 shtatorit.

Në këtë votim brenda partisë pritet që kreu i saj, kryeministri në detyrë, Albin Kurti, të rikonfirmohet mandatar për kryeministër, emrin e të cilit LV-ja do ta dërgojë më pas te presidentja e vendit, Vjosa Osmani, për ta provuar formimin e Qeverisë së re. Megjithatë, situata në Kuvendin e Kosovës mbetet ende e bllokuar dhe nuk është e qartë nëse presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, do ta mandatojë kandidatin e LV-së për kryeministër në këtë gjendje.

Kryesia e re e Kuvendit dështoi ta mbajë mbledhjen e parë, më 1 shtator, në mungesë të kuorumit.

Basha tha për media të hënën se do t'i ftojë në një takim



konsultativ nënkryetarët, por për këtë ende nuk është vendosur asgjë.

Nga Kuvendi nuk kthyen përgjigje nëse pritet të caktohet ndonjë takim i tillë dhe si do të jetë formati i tij.

Sa i përket konstituimit të Kuvendit, që nisi më 15 prill, dhe u shpall i mbyllur pas më shumë se pesë muajsh, Presidenca e Kosovës tha në fillim të javës se ekipi ligjor po e analizon këtë proces. Por,

Presidenca nuk iu përgjigj të enjten Radios Evropa e Lirë nëse janë nxjerrë përfundimet mbi procesin dhe nëse e vlerëson të konstituuar Kuvendin.

Për këtë çështje, presidentja Osmani i priti në takime ambasadorin e Gjermanisë në Kosovë, Jorn Rohde, dhe atë të Mbretërisë së Bashkuar, Jonathan Hargreaves.

Osmani tha se, në lidhje me konstituimin e institucioneve të

vendit, do të veprojë “në përputhje të plotë me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi”. “Në kuadër të diskutimeve, u diskutua edhe procesi i konstituimit të institucioneve si rezultat i zgjedhjeve të 9 shkurtit. Me këtë rast, presidentja Osmani riafirmoi se veprimet e saj do të jenë gjithmonë në përputhje të plotë me Kushtetutën dhe ligjet, duke siguruar stabilitet institucional dhe respektimin e vullnetit

qytetar”, u tha në njoftimin pas takimit me ambasadorin britanik.

Ambasadori gjerman Rohde tha pas takimit me Osmanin se ai ka shprehur shqetësimin për bllokadën e vazhdueshme politike dhe institucionale, “si dhe për diskursin e fundit publik që hedh dyshime mbi vendimet gjyqësore, pasi zhvillime të tilla rrezikojnë ta rrënojnë besimin e publikut në pavarësinë dhe integritetin e gjyqësorit”.

Ambasadori britanik Hargreaves tha se me Osmanin ka diskutuar, ndër të tjera, “nevojën urgjente për hapat e radhës në formimin e Kuvendit, në përputhje me kushtetutën e Kosovës”.

I gjithë procesi i konstituimit të Kuvendit është përcjellë me kritika për shkelje ligjore dhe aktgjykime nga Gjykata Kushtetuese.

Një vlerësim i kushtetutshmërisë nga kjo gjykatë pritet edhe për rastin e fundit të dërguar nga Lista Serbe, e cila e konsideroi shkelje kushtetuese votimin ndaras të dy nënkryetarëve nga komuniteti joshumicë.

Me këtë rast, Emilija Rexhepi arriti votat e nevojshme për t'u bërë nënkryetare nga radhët e komuniteteve pakicë joserbe, por jo edhe kandidati Sllavko Simiq, nga partia më e madhe e serbëve të Kosovës.

Kuvendi mbeti pa e zgjedhur nënkryetarin serb pasi asnjë nga deputetët serbë nuk arritën të zgjidhen as në votimin me short. Kryetari Basha tha të hënën se, pasi u shterua pika e katërt e rendit të ditës - zgjedhja e nënkryetarëve - ka qenë më e rëndësishme që shteti të mos bllokohej për këtë çështje.

PDK-ja BËRI MIRË QË E VOTOI, MENDERMETHËNË, KRYETARIN E KUVENDIT!



Shkruan: Behxhet SH. SHALA

LV-ja ra në kurthin e opozitës: Pas zgjedhjeve të 9 shkurtit 2025, përkundër fitores së LV-së me 42 për qind, skena politike në Kosovë u leopardizua shumë. Asnjë subjekt politik nuk i kishte votat e mjaftueshme, as për Kuvend e as për qeveri. Opozita e lëshoi mundësinë e artë për t'ia lënë "këmbët e arushës" në duar LV-së dhe autokratit Kurthi, që në mbledhjen e parë duke ia shpartalluar planin e mirëpërgatitur të Kurthit për sabotim të formimit të institucioneve. I tërë veprimi opozitar ishte duke e bërë luftën e Don Kishotit

kundër marionetave Dehari dhe Haxhiu, sikur edhe duke provuar nëse autokrati Albin Kurthi i ka votat e domosdoshme për Kuvend dhe Qeveri. Pasi nuk pranuan që në seancën e parë ta votojnë propozimin e Kurthit, LDK-ja, për bindjen time, mori qëndrimin më të drejtë dhe parimor, duke refuzuar çdo propozim të LV-së dhe Kurthit, aksionarit të vetëm të ndërmarrjes antikombëtare dhe antishtetërore - LV-së.

AAK-ja e kushtëzoi votimin me dy emra, e që jam i bindur se nuk e meritojnë, as e para e as e dyta. Ndërkaq, PDK-ja ishte më bujare, duke dhënë një premtim publik se do ta votojë çdo propozim të LV-së përveç atyre që kanë qenë ministra apo zëvendësministra, dhe mbeti peng i një premtimi. Kur LV-ja e propozoi një kloun për kryetar Kuvendi dhe kur PDK-ja nuk e votoi, tmerrësisht u linçua në media si parti që nuk e mban fjalën. Edhe unë e zbrazta një "batore moralizuese kundër PDK-së".

Kur PDK-ja e votoi mendermethënë kryetarin e

Kuvendit, të cilit pastaj i dolën duçat e ndyrë, bashkë me Arsovskën, filluan sulmet ndaj atyre që e votuan në PDK dhe AAK, në emër të një patriotizmi folklorik. Shoqatat e veteranëve kërkuar dorëheqjen e Dimal Arsovskës, disa deputetë mbuloheshin me hi si pendim për votim të gabuar. Nuk mendoj se gabuan ata që e votuan Dimal Arsovskën për kryetar të Kuvendit dhe e kanë gabim që e kërkojnë shkarkimin e tij për shkak të patriotizmit apo tradhtisë. Qe pse: Standardi i mungesës së patriotizmit dhe tradhtisë nuk vlen për Dimal Arsovskën, shkaku se është përcaktuar herët kundër luftës, lirisë dhe UÇK-së. Nuk e ka dhënë asnjë kontribut për, por ka kontribuar shumë kundër. Edhe sot është në ato pozita me përkrahje të fuqishme të partisë që i ndan po ato bindje dhe qëndrime.

Dimal Arsovka është i operuar nga patriotizmi dhe ndjenja e përkrahjeje. Nuk mund dhe nuk keni të drejtë ta detyroni askënd të veprojë në kundërshtim me bindjet dhe përcaktimin

individual, familjar, politik, partiak, moral, kombëtar dhe njerëzor. Ky është brumi i Dimal Arsovskës dhe i partisë që e ka propozuar, prandaj në asnjë mënyrë nuk mund të prisni të dalë një gatim patriotik. Nuk ka alkimi që e bën këtë. As me Dimalin, as me Teneqe Muratin, as me Sipecin, as me rrencën patologjike që gërvallet, as me Lal Cullën apo me marionetat e Kurthit. Apo me këtë Krakovinën e baushtellës. Nuk kanë të kaluar kombëtare, me një të tashme thellësisht antikombëtare, mbesin pa një të ardhme. Dimal Arsovka nuk mund të thirret në përgjegjësi as pse shkoi në Prekaz - kanë shkuar edhe më të këqij. Ky, si kloun, e merr si aktivitet artistik dhe cirku.

Pse bënë mirë që e votuan këtë farë mendermethënë kryetari? E bënë publike të kaluarën e këtij klouni.

E detyruan LV-në ta kandidojë njërin ndër asetet më të çmuara antikombëtare, në mesin e pjesës dërrmuese të anëtarësisë, duke e treguar në publik standardin e kodifikuar antikombëtar dhe

mashtues të LV-së.

E zhveshën botërisht nga ekshibicionet moralizuese.

E përligjën rrencën si spiritus movens të LV-së.

E detyruan Dimal Arsovskën ta shkelë Kushtetutën, duke e instrumentalizuar të shantazhuarin Krasniqi, mendermethënë ministër.

Prandaj, Dimal Arsovka nuk mund dhe nuk duhet të përndiqet për shkak të bindjeve politike dhe përcaktimit kombëtar. Duhet të pranohet se ai mund të jetë edhe anti-UÇK dhe antikombëtar, siç edhe është dëshmuar. Shkarkimi i tij duhet të kërkohej, shkaku se me vetëdije, qëllim dhe vullnet e shkeli Kushtetutën, ligjet dhe Rregulloren e Kuvendit, sikur që e detyroi ministrin Krasniqi të bëjë shkelje të Kushtetutës, ligjeve dhe Rregullores. Ky, bashkë me të tjerët, e formuan një ndërmarrje të strukturuar kriminale me qëllim të sabotimit të formimit të institucioneve, duke rrënuar bazat e shtetit përmes dhunimit të Kushtetutës së Kosovës. Hiç më pak!

KURTI NË KONFERENCËN 'KOSOVAPAR2025': KEMI NDËRMARRË REFORMA TË THELLA NË TË GJITHË SEKTORËT

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, mori pjesë në ditën e dytë të Konferencës Ndërkombëtare për Administratë Publike - 'KosovaPAR2025', e cila organizohet nga Ministria e Punëve të Brendshme. Në fjalën hyrëse, kryeministri u shpreh se gjatë këtyre 25 viteve në Kosovë ka ndodhur një proces i shtetndërtimit, pra i veçantë, i pashembullt ndokund tjetër apo ndonjëherë tjetër.

Ai ka renditur raportet e fundit të organizatave si Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, SIGMA, organizata Gallup, Transparency International, World Justice Project e të tjera, të cilat dëshmojnë se Kosova është rast suksesi i shtetndërtimit pas një lufte të tmerrshme. "Gjatë këtyre katër viteve të fundit qeveria që udhëheq unë ka ndërmarrë reforma të thella në të gjithë sektorët në mënyrë që ndryshimet pozitive të jenë edhe të qëndrueshme në kohë për të ardhmen, por edhe të pakthyeshme, pra që të pamundësojmë hapat prapa", tha kryeministri.

Duke qenë se konferenca ka të bëjë me administratë publike dhe institucione, kryeministri Kurti përmendi tri raporte: raporti i SIGMA/OECD, i cili renditë Kosovën në vitin 2024 më mirë se mesatarja e Ballkanit perëndimor në të gjitha gjashtë fushat në të cilat bëhen matjet, veçanërisht kur e krahasojmë me vitin 2021



kur Kosova ishte më keq se mesatarja e Ballkanit në pesë prej gjashtë fushave është i dukshëm përparimi i bërë.

Megjithatë, kryeministri theksoi se gjatë fazës së shtetndërtimit të tyre kanë ndodhur dy fenomene të cilat janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën. "Së pari, një proces i stër-agjencifikimit, pra i shtimit tej mase të agjencive, që ka sjellë krijimin e një numri të madh të trupave të ekzekutivit e të pavarura, shpeshherë të

panevojshme dhe, së dyti, një numër i madh i këtyre agjencive ka fituar statusin e agjencive të pavarura, pa justifikim, madje shpeshherë këto agjenci me funksione ekzekutive janë vendosur nën legjislativin, që përsëri është problematike. Kështu, duke krijuar shumë agjenci, shumë prej tyre në emër të pavarësisë nuk kanë raportuar në vendin e duhur, nuk kanë dhënë llogari për punën dhe performancën e tyre; shumë prej

tyre kanë mbetur jashtë çdo rregullimi adekuat në emër apo si pasojë e keqinterpretimit të pavarësisë, herë me qëllim e herë nga mosdija apo mosekzistenca e mekanizmave adekuat për t'u marrë me këto çështje", ka thënë ai.

Andaj, tha kryeministri Kurti, është me rëndësi të hapim bashkërisht këtë debat të rëndësishëm rreth pavarësisë së institucioneve dhe ta gjejmë baraspeshën e duhur midis

pavarësisë, bashkëpunimit dhe llogaridhënies, ashtu që institucionet të funksionojnë sa më mirë dhe jeta e qytetarëve të përmirësohet sa më shumë. Konferenca KosovaPAR2025 ka nisur punimet të mërkurën përmes 14 paneleve, dy sesioneve kryesore, me përfaqësues nga niveli i lartë shtetëror, komuniteti diplomatik, akademikë, zyrtarë publikë, shoqëri civile dhe përfaqësues shtetërorë nga rajoni dhe më gjerë.

Ushtria e Kosovës, pjesë e ushtrimit të NATO-s në Gjermani

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Me ftesë të ushtrisë amerikane, Forca e Sigurisë së Kosovës me një kontingjent u është bashkuar ushtrive partnere të ShBA-së, në ushtrimin fushor “Saber Junction 25” në Hohenfels të Republikës së Gjermanisë. Ushtrimi është i dizajnuar të testojë dhe vlerësojë gatishmërinë e njësive luftarake të ekipeve luftarake të Brigadës së Këmbësorisë dhe njësive të tjera si pjesë e rotacionit për misionin e KFOR-it në Kosovë. Forca e Sigurisë së Kosovës po merr pjesë me një Kompani të Këmbësorisë dhe një skuadër të Materieve të Rrezikshme (CBRN) me qëllim demonstrimin e profesionalizimit dhe ndërveprueshmërinë me vendet partnere.



KOSOVA NGRE AKTAKUZË PËR SPIUNAZH NDAJ ISH-PUNONJËSES SERBE TË OSBE-SË

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Prokuroria Speciale e Kosovës ka ngritur të enjten aktakuzë kundër të pandehurës J. Gj. - nga komuniteti serb - nën dyshimet për kryerje të veprës penale të “spiunazhit”. E pandehura, e cila ka punuar në misionin e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), në degën në Mitrovicë, është arrestuar më 28 shkurt të këtij viti në Jarinjë, pikë e kalimit mes Kosovës dhe Serbisë. Prokuroria ka thënë se për një afat të pacaktuar e deri në ditën e arrestimit e pandehura “me vetëdije ka kryer veprime të përsëritura që përbëjnë ndihmë aktive për veprimtarinë informative të një shërbimi të huaj, konkretisht të Agjencisë për Inteligjencë dhe Siguri të Republikës së Serbisë (BIA)”. Sipas Prokurorisë, ajo ka bashkëpunuar me Aleksandar Vllajiqin, dhe duke marrë udhëzime prej tij, ka përpiluar

raporte të OSBE-së për pasqyrim të situatës politike dhe sigurisë në Kosovë dhe ka kontribuar në krijimin e një narrative armiqësore ndaj institucioneve të sigurisë, shtetësisë dhe integritetit të Kosovës. Autoritetet e Kosovës e kanë dënuar Vllajiqin në qershor të këtij viti me pesë vjet burgim, pasi ai e kishte pranuar fajësinë, duke thënë se është përfshirë në spiunazh si anëtar i BIA-s serbe. Ai është dënuar edhe për posedim të paligjshëm të armëve. Prokuroria ka thënë se J. Gj. ka siguruar dhe shpërndarë dokumente të ndjeshme për interesa të BIA-s, dhe që këto veprime kanë cenuar rendin kushtetues, sigurinë kombëtare të Kosovës dhe kanë vënë në rrezik jetën dhe sigurinë e zyrtarëve shtetërorë, qytetarëve dhe personelit ndërkombëtar të OSBE-së në Kosovë. “Sipas provave të siguruar gjatë



hetimeve, informacionet e siguruar nga J. Gj. janë transmetuar të zyrtarët e lartë të BIA-s, përkatësisht R. G., përgjegjës i BIA-s për Rajonin

e Novi Pazarit në Serbi, dhe zyrtari L. B., ku me këtë të fundit e pandehura në disa raste edhe është takuar në Beograd të Serbisë”, është

thënë në komunikatën e Prokurorisë. Muajt e fundit autoritetet e Kosovës kanë arrestuar, akuzuar dhe gjykuar serbë e shqiptarë nën dyshimet se kanë spiunuar për shërbimet e inteligjencës së Serbisë. Në Kosovë spiunazhi përkufizohet aktivitetet sekret i mbledhjes, transmetimit ose shpërndarjes së informacionit të ndjeshëm në një shtet, organizatë ose grup tjetër. Sipas Kodit Penal të Kosovës, spiunazhi konsiderohet krim i rëndë dhe dënohet me të paktën pesë vjet burgim, nëse i dyshuari shpallet fajtor. Ekspertët kanë thënë se spiunazhi është kërcënim serioz për sigurinë e Kosovës dhe arrestimet e fundit vetëm sa nxjerrin në pah rrezikun e vazhdueshëm. Sipas tyre, ky aktivitet jo vetëm që destabilizon vendin brendapërbrenda, por dëmton edhe pozitën ndërkombëtare.

URAN ISMAILI: SI KRYETAR I PRISHTINËS NUK DO TË FSHIHEM PAS PREMTIMEVE



PRISHTINË, 4 SHTATOR - Kandidati i PDK-së për kryetar të Prishtinës, Uran Ismaili, ka kritikuar kryetarin aktual të komunës, duke thënë se qeverisja e tij ka dështuar për shkak të mungesës së aftësive për t'i realizuar projektet e premtuara. “Fatkeqësisht kemi zgjedhur kryetarë që nuk i kanë pasur shkathtësitë për t'i realizuar projektet që vetë i kanë premtuar. Nuk po flasim për projekte të imponuara, por për ato që i kanë propozuar vetë e që nuk janë realizuar”, tha Ismaili. Ai shtoi se kryetari aktual nuk mund të justifikohet me akuza

ndaj të tjerëve, kur ka pasur në dispozicion buxhetin më të madh se çdo komunë tjetër në vend. “Nuk mundesh pareshtur për katër vjet me thënë që ‘nuk kam mujt me punu, nuk më kanë lënë me punu’, kur i ke pasur krejt mundësitë”, theksoi ai. Sipas Ismailit, përgjegjësia për gjendjen në qytet bie drejtpërdrejt mbi kryetarin, nëse shërbimet dhe lagjet nuk janë në rregull. Ai premtoi se nëse zgjedhet në krye të komunës nuk do të fshihet pas arsyetimeve. “Në momentin që zgjedhem kryetar i komunës, arsyetimet nuk janë në fjalorin tim”, përfundoi Ismaili.

Dogana dhe Inspektorati ndalojnë 275 lodra të dyshuara për pirateri

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Dogana e Kosovës, në bashkëpunim me Inspektoratin e Tregut, ka ndërmarrë një aksion të përbashkët kundër produkteve që dyshohet se shkelin të drejtat e autorit dhe të pronësisë intelektuale. Sipas njoftimit zyrtar, gjatë 12 inspektimeve në tregun e brendshëm janë ndaluar nga qarkullimi 275 njësi lodrash për fëmijë për të cilat ekziston dyshimi se cenojnë të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta. Këto veprime janë pjesë e angazhimit të Task Forcës Kundër Piraterisë dhe synojnë forcimin e zbatimit të ligjeve që mbrojnë pronësinë intelektuale në Kosovë. “Dogana e Kosovës dhe Inspektorati i Tregut mbeten të përkushtuar për mbrojtjen e të drejtave të autorit dhe do ta vazhdojnë bashkëpunimin me institucionet ligjzbatuese për të parandaluar dhe luftuar fenomenin e piraterisë dhe falsifikimit në tregun e brendshëm”, thuhet në njoftimin e Doganës.



FUQIZOHEN GRATË SIPËRMARRËSE TË AGROBIZNESIT NË KOSOVË

Bujqësia është burimi kryesor i të ardhurave për familjet rurale në Kosovë. Përmes granteve të Ministrisë gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (BMZ), 93 gra fermere “kanë marrë në dorë frerët” e sipërmarrjes në Kosovë

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Në fshatin Komogllavë të komunës së Ferizajt në Kosovë, Arbresha Beqiri kujdeset për lopët dhe viçat e saj. Prej 14 vitesh ajo dhe bashkëshorti, bashkë me pjesën tjetër të familjes, zotërojnë fermën e cila është burimi kryesor i financave. “Ne kujdesemi për 30 lopë qumështore dhe 10 viça. Në ditë marrim 450 litra qumësht dhe e dërgojmë në pikën grumbulluese. Atje përpunohet dhe shpërndahet më tej”, thotë për “DW” sipërmarrësja e re. Në vitin 2022 ajo dhe bashkëshorti morën rrugën e migrimit për në Slloveni, ku menduan ta ndërtojnë jetën. Pasi qëndruan atje për pak kohë, vendosën të kthehen në fshat dhe ta rigjallërojnë biznesin familjar. Një grant i dhënë nga Ministria gjermane për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin (BMZ), përmes shoqatës humanitare “CARE”, u mundësoi të blinin pajisje për punimin e tokës dhe ushqyerjen e bagëtive. Çdo anëtar i familjes Beqiri investon pjesën më të madhe të kohës për fermën. Megjithatë, ajo që duket se e shijon më tepër sipërmarrjen është Arbresha. “Është mirë të jesh e pavarur dhe të punosh si për vete ashtu edhe për fëmijët, për familjen. Unë kujdesem si për vajzat ashtu edhe për fermën”, thotë ajo. Pak kilometra larg Prishtinës, në Bërnice të Poshtme, Gjyla Thaçi po kontrollon specat në serrën e saj. Ajo ka përfunduar ditën e saj të punës si mësuese e shkencave juridike dhe pjesën e mbetur të ditës e kalon tek sipërmarrja e re, për të cilën ndihet krenare. E rritur që fëmijë mes bujqësisë, Gjyla nuk u shpëtoi kurrë nga dashuria për tokën dhe të mbjellat. Sot ajo zotëron serrën prej 200 metrash katrorë, ku kultivon perime të freskëta. Por fillimisht, pa marrë mbështetjen nga fondet e BMZ, produktet rriteshin në fushë, çka nënkuptonte sfida më të mëdha për Gjylën. “Fillimisht ka qenë e vështirë. Ka pasur sfida, sepse kultivimi i bimëve jashtë serrave



ka një rrezikshmëri të lartë, për shkak të kushteve atmosferike. Mirëpo kur ndërtuam serrën, iu shmangëm rrezikut dhe kultivimi u bë më i mirë dhe me rendiment më të lartë”, thotë Gjyla për “Deutsche Welle”-n.

Kosova, “vend i mundësive”

Gjatë luftës ajo dhe familja e saj jetuan për rreth tre vjet në Austri, por me mbarimin e luftës ata nuk kishin asnjë dilemë për rikthimin. “Ndiheva mirë në vendin tim. Kosova është vend në tranzicion dhe dihet që ka shumë sfida, por këtu është vendi i mundësive. Vetëm të kesh dëshirë dhe vullnet”. Edhe Makfira Avdiu, nga fshati Gaçkë në Ferizaj, u largua me familjen drejt Gjermanisë për t’i shpëtuar luftës. Atje fitoi përvojë duke punuar në serrë, dije të cilat po i përdor edhe sot. Njësoj si Gjyla ajo u rikthye në Kosovë dhe sot zotëron serrën 300 metra katrorë, multikultivatorin dhe panelin diellor, të cilat i vijnë në ndihmë për të gjitha proceset bujqësore. “Bimëve duhet t’u rrish gati. Bima nuk të pyet nëse je lodhur, nëse është vapë apo

natë, por duhet të kujdesesh për të. Për serrën duhet të zgjohesh herët dhe të punosh në mbremje, deri vonë”, thotë Makfira.

“Gratë për gratë”: Financa më të mira, ndryshim mentaliteti

93 gratë fermere të Kosovës u mbështetën financiarisht nga BMZ përmes “CARE” dhe organizatave vendase. Projekti IWKA - “Përfshirja e grave në biznesin bujqësor në Kosovë” ofroi grante deri në 10 mijë euro dhe trajnime në sipërmarrje. “Ajo çfarë ne bëjmë shpeshherë, është ta ndezim shkëndijën e tyre sipërmarrëse, idenë që ato kanë. Gratë mësohen që produktet të cilat shpesh i falin, t’i shesin, sepse kanë mundësi të fitojnë. Dhe ndryshimi i mentalitetit që një grua e pashkolluar nuk mund të jetë fitimprurëse dhe të gjenerojë të ardhura, ndryshon me programin tonë”, thotë Iliriana Gashi, drejtorë ekzekutive nga Shoqata “Gratë për gratë”. Gratë sipërmarrëse - të cilat prodhojnë ajvar, piper të kuq, punojnë me nxjerrjen e mjaltit, kultivojnë perime - janë

organizuar tashmë në katër shoqata, përmes të cilave synojnë të frymëzojnë edhe gratë e tjera që dëshirojnë të hyjnë në tregun e sipërmarrjeve të vogla nëpër fshatra. Edhe pakicat në Kosovë janë pjesë e programit. “Kemi themeluar shoqatën në mënyrë që të jemi të dukshme, të bëhemi një. Në të ardhmen planifikojmë që të rekrutojmë edhe të tjera gra që janë ‘të padukshme’ e t’u ndihmojmë atyre t’ia dalin mbanë e të bëhen pjesë e kësaj sipërmarrjeje”, thotë Dragana Simić, sipërmarrëse serbe që jeton në zonën e Graçanicës. Në rrugëtimin e saj drejt sipërmarrjes, ajo ka ndeshur dhe paragjykimet, të cilat çuditërisht i ka ndier më së shumti nga gratë e tjera. “Ua tregoj rrugëtimin tim dhe se çfarë do të thotë të jesh e pavarur, të punosh vetë dhe të kesh kartën tënde të bankës e të mos varesh nga burri. Derisa të kem shëndet edhe jetë, nuk ndalem”. “Kemi parë që shpeshherë bizneset të cilat i kanë themeluar gratë, janë shndërruar në biznese familjare dhe u janë bashkangjitur burrat, djemtë, vajzat, e gjithë familja. Janë ato që në anglisht quhen ‘role models’. Janë gra të cilat japin shembull.

Shohim që në një fshat ku gruaja ka pasur sukses dhe familja e ka jetën më të mirë, ka më pak rezistencë nga ana e familjeve të tjera në të njëjtin komunitet”, thotë Iliriana Gashi.

Ndihmë ligjore falas për problemet e pronësisë

Një ndër sfidat ligjore për këto gra sipërmarrëse ka qenë problemi i pronësisë. Në shumicën e rasteve, emri i tyre nuk rezultonte zyrtarisht në certifikatën e pronësisë. Atyre iu ofrua ndihmë ligjore falas gjatë të gjithë procesit, në mënyrë që të kapërcehej ky ngërç ligjor. “Kemi advokuar përmes Zyrës së Noterisë në Kosovë dhe kemi arritur që përmes një dokumenti noterial të tejkalojmë këtë problem dhe këto gra të kenë mundësi të aplikojnë me një dokument të vërtetuar noterial se prona për të cilën është menduar të investohet përmes këtij projekti, të evidentohet si pronë që për momentin nuk është në emër të aplikueses apo bashkëshortit të saj, por është në proces gjyqësor dhe nuk ka kundërshtim për pronën”, thotë Memli Ymeri, drejtor ekzekutiv i “Programit për të Drejtat Civile” në Kosovë.

Kryeprokurori i Shtetit dhe drejtori i ATK-së diskutojnë për thellimin e bashkëpunimit


PRISHTINË, 4 SHTATOR - Ushtruesi i detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, së bashku me udhëheqësin e Zyrës për Rikthimin e Aseteve, prokurorin Bahri Hyseni, kanë pritur në takim drejtorin e ri të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Mentor Hyseni, me bashkëpunëtorë.

Gjatë takimit u diskutua për rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstucional dhe veprimet e përbashkëta në funksion të zbatimit të ligjit dhe luftimit të veprave penale që cenojnë sistemin tatimor në Republikën e Kosovës. Të dy drejtuesit institucionalë ritheksuan përkushtimin për forcimin e sundimit të ligjit

përmes përkrahjes së ndërsjellë dhe efikase, duke vlerësuar se mbështetja reciproke ndërmjet Prokurorit të Shtetit dhe Administratës Tatimore është thelbësore për parandalimin dhe luftimin e dukurive të paligjshme që dëmtojnë buxhetin dhe interesin publik.



ÇUDIA PËR HUAN RULFON



Nga: Gabriel Garcia
MARQUEZ

Zbulimi i Juan Rulfos – si ai i Franc Kafkës – pa dyshim, do të jetë një kapitull themelor në kujtimet e mia. Kisha mbërritur në Meksiko më 2 korrik 1961, pikërisht ditën që Ernest Heminguej i dha fund jetës me një të shtënë. Unë, jo vetëm nuk i kisha lexuar librat e tij, por as që kisha dëgjuar të flitej për të. Jetoja në një apartament pa ashensor, në rrugën Renan, në lagjen Anzures. Kishim një dopio dyshek, për sheshi, në një dhomë gjumi të madhe, një djep në dhomën tjetër, ndërsa në mesore një tavolinë për të ngrënë e për të shkruar dhe dy karrige të vetme që na shërbenin për gjithçka. Kishim vendosur të qëndronim në këtë qytet i cili ende ruante një përmasë humane, me një ajër të tejdukshëm dhe me bulevardet plot lule me ngjyra të dalldisura, por autoritetet e emigracionit nuk po na i bënë mundur gëzimin tonë. Kësisoj, gjysma e jetës, aty, do të na kalonte duke qëndruar në radhë, pa lëvizur e nganjëherë në shi, në oborre të mërztishme të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Unë atëherë isha 32 vjeç dhe kisha bërë në Kolumbi një karrierë jetëshkurtër gazetareske; kisha kaluar nja tre vjet shumë të dobishëm dhe të ashpër në Paris, nja tetë muaj në Nju-Jork, dhe doja të bëja skenarë filmash

në Meksiko. Bota e shkrimtarëve meksikanë në atë kohë ishte e ngjashme me atë të Kolumbisë dhe u ndjeva shumë mirë midis tyre. Gjashtë vjet më parë kisha botuar romanin tim të parë “Gjethnaja” dhe kisha tre libra të tjerë gati për botim: “Koloneli nuk ka kujt t’i shkruajë”, që doli më pas në Kolumbi; “Ora e keqe”, që u botua nga Shtëpia Botuese “Era”, pak kohë pas kërkesës së Visente Rojos, dhe vëllimin me tregime “Funeralet e nënëmadhes”. Kësisoj, unë isha një shkrimtar me pesë libra klandestinë, por problemi im nuk ishte ky, sepse, as atëherë e as ndonjëherë tjetër nuk kam shkruar për të qenë i famshëm, por që miqtë e mi të më donin më shumë, gjë që besoja se do ta arrija. Problemi im i madh si romancier ishte se pas këtyre librave ndihesha sikur të qenësha futur në një rrugicë pa krye dhe po kërkoja me ngulm një shteg për të dalë. Njoha plot autorë të mirë dhe të këqij, të cilët mund të më tregonin rrugën e, megjithatë, ndihesha se po vija vërdallë në rrathët bashkëqendrorë, pa e përfillur lodhjen; përkundrazi, ndieja se ende më mbeteshin mjaft libra pezull, veç nuk po gjeja dot një mënyrë bindëse dhe poetike për t’i shkruar. Isha në këto andralla kur Alvaro Mutis, me hapa të gjatë, ngjiti të shtatë katet e pallatit tim me një pako librash në dorë, prej të cilave nxori librin më të vogël dhe, duke u shkrirë

në gaz, më tha: “Dreqi ta marrë, lexoje këtë mashtrues, nëse do të mësoh!” Ishte “Pedro Paramo”. Atë natë nuk vura gjumë në sy, derisa e mbarova së lexuari për të dytën herë; qysh nga nata e tmerrshme kur, nja dhjetë vjet të shkuara, kisha lexuar “Metamorfozën” e Kafkës, në një bujtinë të kobshme studentësh të Bogotasë, kurrë nuk kisha përjetuar një tronditje të ngjashme. Të nesërmen lexova vëllimin me tregime Rrafshina në flakë dhe u çmerita njëlloj. Shumë më vonë, në paradhomën e një konsultoreje, në një revistë mjekësore, gjeta tregimin kryevepër të Rulfos, “Trashëgimia e Matilda Arkanhelit”. Pjesën tjetër të atij viti nuk munda të lexoj asnjë autor tjetër, sepse të gjithë më dukeshin kot. Ende nuk më qe fashitur trandja, kur dikush i tha Karlos Velos* se unë qenësha i aftë t’i recitoja përmendsh paragrafë të tërë nga “Pedro Paramo”. E vërteta ishte edhe më: mund të recitoja komplet librin nga fillimi në fund dhe anasjelltas, pa ndonjë gabim të ndjeshëm, madje, mund të thosha se në cilën faqe të botimit që kisha unë gjendej çdo episod dhe nuk kishte tipar të karakterit të secilit personazh që të mos e njihje në thellësi. Më vonë, Karlos Vela dhe Karlos Fuentes më ftuan që bashkë me ta të bënim rishikimin kritik të adaptimit të parë të “Pedro Paramos” për film. Kishte dy probleme

të qenësishme: së pari, ishte puna e emrave. Sado subjektive që duket, çdo emër, në një farë mënyre, i ngjan atij që e mban dhe kjo është shumë më e dukshme në fiksion sesa në jetën reale. Huan Rulfo ka thënë, ose ia kanë bërë të thënë, se i vinte emrat e personazheve të tij, duke lexuar gurët e varreve nëpër varrezat e Haliskos; e vetmja gjë që mund të thuhet me siguri, është se nuk ka emra të përveçëm më të veçantë se ata të njerëzve në librat e tij; mua më dukej e pamundur, dhe vazhdon ende të më duket ashtu, se nuk mund të gjeja kurrë një aktor që të identifikoj, pa asnjë mëdyshje, me emrin e personazhit të tij. E keqja e këtyre shqyrtimeve të këndshme është se kokëfortësitë e frymëzimit nuk janë gjithmonë të njëjtat nga arsyeja. Muajt kur ndodhën disa fakte janë thelbësore për analizën e veprës së Huan Rulfos dhe unë dyshoj nëse ai ka qenë i vetëdijshëm për këtë. Në punën poetike – dhe “Pedro Paramo” është i tillë, në shkallën më të lartë – autorët zakonisht thërrasin muajt për zotime të ndryshme me saktësi kronologjike; edhe më: në plot raste ndryshohet emri i muajit, i ditës, madje edhe i vitit, vetëm e vetëm për t’iu shmangur një rime të papërshtatshme apo dëgjimit të një kakofonie, pa menduar se këto ndryshime mund ta çojnë në një kritikë apo në një ngatërresë përfundimtare. Kjo ndodh jo

vetëm me ditët dhe muajt, por edhe me lulet; ka shkrimtarë që nuk merren me to, me rëndësinë e vërtetë të emrave të tyre, duke mos u thelluar fare nëse përshtaten me vendin apo stinën; kësisoj, nuk është çudi të lexosh libra të mirë ku gjen të lulëzojnë lulemëllaga në rërë dhe tulipanë në dëborë. Te “Pedro Paramo”, ku është e pamundur të përcaktosh në mënyrë përfundimtare kufirin midis të vdekurve dhe të gjallëve, përpikëritë janë edhe më kimerike, askush nuk mund të dijë në të vërtetë se sa zgjatin vitet e vdekjes. I rendita këto pak rreshta, për të thënë, në fund të fundit, se shqyrtimi deri në thellësi i veprës së Huan Rulfos, tek e mbramja, më hapi rrugën për të kërkuar vazhdimin e librave të mi dhe, mu për këtë, e kisha të pamundur të shkruaja për të, pa m’u dukur se e gjitha kjo ishte për mua vetë. Tani po ju them se u ktheva për ta rilexuar edhe një herë gjithë veprën e tij për të shkruar këto shënime të shkurtra nostalgjike, duke u bërë kështu edhe një herë viktimë e pafajshme e së njëjtës çudi, si në rastin e parë; nuk janë më shumë se 300 faqe, por janë, këtë e besoj plotësisht, aq të përjetshme sa ato që njohim nga Sofokliu. Nëse unë do të kisha shkruar “Pedro Paramon”, nuk do të merrja kurrë guximin të kthehesha e të shkruaja përsëri në jetën time.

/Përktheu: Bajram
KARABOLLI



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Osmani: Edhe stadiumi i Prizrenit po bëhet

Projekti për rinovimin e stadiumit të Prizrenit “Përparim Thaçi” është në fazën finale të procedurave dhe së shpejti do të nënshkruhet kontrata. Kjo është

bërë me dije nga zëvendësministrja në detyrë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Daulina Osmani. “Edhe stadiumi i Prizrenit po bëhet! Jemi në prag

të nënshkrimit të kontratës për një projekt me vlerë trembëdhjetë milionë euro, që parasheh modernizimin e plotë të stadiumit në një arenë

moderne sipas standardeve të UEFA-së, me kapacitet prej 7 mijë e 750 ulësesh”, ka thënë Osmani. Sipas saj, ky investim nuk është vetëm lajm i mirë për

klubin historik Liria, por edhe për gjithë komunitetin sportiv dhe tifozët prizrenas që presin një infrastrukturë dinjitoze për futbollin në qytet.

DITA E ‘DARDANËVE’



EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 4 SHTATOR - E premtja është dita e “dardanëve”, pasi Përfaqësuesja A dhe ajo U21 do t'i zhvillojnë ndeshjet e para kualifikuese. Kosova e drejtuar nga përzgjedhësi Franco Foda ka arritur të enjten në Bazël, ku edhe zhvilloi stërvitjen e fundit para ndeshjes me Zvicrën, e cila zhvillohet sonte në stadiumin “St. Jakob-Park”. Foda ka thënë se “dardanët në këtë ndeshje hyjnë për një rezultat pozitiv. “Do të hyjmë në këtë sfidë me mendësi pozitive dhe do të shohim se ku do të na çojë ky rrugëtim. Qëllimi ynë është i qartë: për herë të parë të kualifikohemi në një kompeticion të madh”, ka thënë Foda, i cili ka treguar se lojtarët do të motivohen nëpërmjet një video. Trajneri gjerman i Kosovës e ka pranuar se “dardanët” janë në një grup të vështirë, por synimet janë të mëdha. “Jemi në një grup shumë të vështirë. Zvicra dhe Suedia janë ekipe me shumë cilësi. Edhe Sllovenia, e cila u kualifikua herën e fundit në Evropian, ka një ekip shumë të mirë. Por, pavarësisht prej të gjithave, gjithçka është e mundur. Edhe ne kemi cilësitë dhe mundësitë tona. Vendi i parë kualifikohet direkt, ndërsa ekziston edhe mundësia që përmes ‘play-off’-it të luftojmë për vendin e dytë.

Ne luajmë futboll dhe jetojmë për futbollin. Ëndrrat bëhen realitet vetëm kur beson vërtet dhe je i bindur se mund të arrish. Këtë mesazh do t’ua përcjell edhe lojtarëve gjatë javës. E dimë që nuk është grup i lehtë dhe se jemi autsajder, por edhe një autsajder mund të jetë shumë i rrezikshëm. Ne do të japim gjithçka për vendin tonë, për Kosovën, që për herë të parë të kualifikohemi në Kupën e Botës”, ka shtuar Foda.

Ndeshja në mes të Zvicrës dhe Kosovës do të zhvillohet nga ora 20:45, kurse atmosfera do të jetë elektrizuese, pasi janë shitur të gjitha biletat dhe stadiumi do të jetë i stërmbushur. Krahas Përfaqësueses A, edhe U21-shat sot (e premtë) do të përballen me Rumaninë, në ndeshjen e parë të ciklit kualifikues për Kampionatin Evropian 2027. Përzgjedhësi Afrim Tovërlani ka thënë se janë të vetëdijshëm për vështirësinë e grupit, ku krahas Rumanisë bëjnë pjesë edhe Spanja dhe përfaqësuese të tjera cilësore, por që ekipi “dardan” do ta japë maksimumin në çdo përballje. “Na presin dy ndeshje të vështira, me Rumaninë dhe Spanjën, por fillimisht jemi të fokusuar te ndeshja e parë. Rumania dhe Spanja janë favorite të grupit, por ne nuk dorëzohemi. Edhe herën e kaluar kemi pasur një grup shumë të vështirë dhe ia kemi dalë me

sukses. Kemi gjeneratë të re, me shumë prurje, por besoj se me një kolektiv të shëndoshë mund të arrijmë rezultate pozitive. Gjithsesi, synimi ynë pas 10 ndeshjeve është të arrijmë një kualifikim historik, por gjithçka mbetet ta tregojmë në fushë”, ka deklaruar Tovërlani.

Trajneri i Zvicrës: Nuk ka më ndeshje ‘vëllazërore’

Trajneri i Zvicrës, Murat Yakin, në prag të ndeshjes kundër Kosovës, e cila do të zhvillohet nesër në Bazël, në kuadër të kualifikueseve ka theksuar se kjo përballje nuk duhet parë më si një ndeshje miqësore mes dy vendeve me lidhje të afërta. “Dikur flitej për një duel vëllazëror, një ndeshje miqësore... Por kjo histori ka marrë fund. Nuk do të ketë më të tilla”, u shpreh prerazi ai, duke treguar qartësisht se Zvicra e trajton këtë sfidë me seriozitet të plotë. Yakin është i vetëdijshëm për komunitetin e madh shqiptar në Zvicër dhe pret një atmosferë të zjarrtë në “St. Jakob-Park”. “Besoj se do të kemi një mbështetje të ndarë në mënyrë të barabartë - 50 për qind për ne, 50 për Kosovën apo Shqipërinë”, ka shtuar ai. Sa iu përket objektivave në grup, trajneri zviceran shprehu besimin se ndeshjet në shtëpi do të jenë vendimtare për ecurinë e ekipit.

Shkurt

Shtatori, muaji i Kupës Ballkanike për klube që e organizon KV Drita

Kupa e BVA-së në voleyboll për femra do të zhvillohet nga data 25 deri më 28 shtator në Kosovë. KV Drita e ka konfirmuar pjesëmarrjen, madje këtë vit mban rolin e nikoqires, ndërsa pjesëmarrëse do të jenë edhe tri skuadra të njohura rajonale: AEK Athina nga Greqia, Fit Fun Volley nga Maqedonia e Veriut dhe Herceg Novi nga Mali i Zi. Në ditën hapëse të garës, më 25 shtator, në orën 15:30 do të përballen AEK Athina dhe Fit Fun Volley, ndërsa në orën 17:30 do të zbresin në parket nikoqirët e KV Drita kundër ekipit të Herceg Novit. Dita e dytë do të sjellë dy sfida të tjera: Herceg Novi-AEK Athina dhe Fit Fun Volley-KV Drita. Pas një dite pushimi turneu do të mbyllet me duelet e fundit më 28 shtator, ku fillimisht do të takohen Herceg Novi me Fit Fun Volley, për t’u përmbyllur me supersfidën AEK Athina-KV Drita. Skuadra fituese e Kupës së BVA-së do të sigurojë një vend të vlefshëm për garat evropiane, konkretisht në CEV Challenge Cup.

FC Prishtina huazon tre futbollistë

FC Prishtina ka njoftuar se ka huazuar tre futbollistë për sezonin 2025/26, me synimin për ta ndihmuar zhvillimin e tyre profesional dhe për të fituar më shumë përvojë në skuadra të ndryshme të futbollit të Kosovës. Ardi Ajdini është huazuar te KF Liria e Prizrenit, ku pritet të ketë rol kyç në formacion dhe të kontribuojë në realizimin e objektivave ambicioze të klubit për këtë sezon. Ardi shihet si një nga lojtarët më premtues në repartin defensiv dhe kjo lëvizje do t’i shërbejë shumë rritjes së tij. Drin Bajraktari, mbrojtësi i krahut të majtë, do ta vijojë sezonin me KF Vushtrrinë. Me disiplinën dhe shpirtin luftarak që e karakterizon, Drini pritet të jetë një përforcim i rëndësishëm për skuadrën nga Vushtrria. Ndërkohë, Flori Spahija i është bashkuar ekipit të KF Vjosa nga Shtimja. Ky huazim është një mundësi e mirë për Florin që ta shfaqë potencialin e tij dhe të kontribuojë në suksesin e klubit gjatë kampionatit. “Ne si klub u dëshirojmë suksese këtyre futbollistëve dhe besojmë se kjo përvojë do t’u ndihmojë të kthehen edhe më të fortë në të ardhmen te klubi ynë”, thuhet në njoftimin e Prishtinës.

Klubet greke interesohen për Rashicën

Milot Rashica pritet të largohet nga Beshiktashi, me klubin turk që po kërkon ta shesë deri javën e ardhshme. Afati

kalimtar në Turqi dhe Greqi mbyllet më 14 shtator, dhe disa ekipe greke kanë shfaqur interesim për 29-vjeçarin,

megjithëse emrat e tyre nuk janë zbuluar. Trajneri Sergen Yalcin nuk llogarit në Rashicën, i cili ka kontratë me klubin deri

më 2027 dhe ka regjistruar 86 ndeshje, 11 gola dhe 19 asistime që nga viti 2023. Beshiktashi po shqyrton ofertat, si nga Greqia

ashtu edhe nga klube turke. Përveç Rashicës, në listën e largimeve është edhe sulmuesi shqiptar Ernest Muçi.

Berisha vazhdon me KB Peja

PEJË, 4 SHTATOR - Basketbollisti i njohur Dardan Berisha do të jetë pjesë e KB Peja edhe për sezonin e ri 2025/2026. Klubi pejan e ka bërë me dije këtë lajm përmes një njoftimi zyrtar në faqen zyrtare, duke konfirmuar vazhdimin e

bashkëpunimit me yllin e skuadrës. “Basketbollisti më i mirë shqiptar i të gjitha kohëve, Dardan Berisha, vazhdon në shtëpinë e tij edhe për edicionin 2025/26”, thuhet në deklaratën e klubit, duke shprehur krenarinë për vazhdimin e

bashkëpunimit me njërin nga figurat më të rëndësishme të historisë së klubit dhe basketbollit të Kosovës në përgjithësi. Berisha, i njohur për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në zhvillimin e basketbollit në Kosovë dhe

për përfaqësimin dinjitoz në arenën ndërkombëtare, ka qenë lider dhe motor kyç për KB Pejën në shumë sezone. Përvoja e tij, talenti dhe përkushtimi ndaj fanellës verdhë, e bëjnë atë një figurë të pazëvendësueshme në skuadër.



Ademi për ‘Blick’: Kosova nuk i ka marrë askujt me zor, Avdullahu vendosi me zemër

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, ka dhënë një intervistë për medien zvicerane “Blick”, ku ka folur për marrëdhëniet në mes të futbollit të Kosovës dhe atij zviceran, si dhe për zgjedhjen e mesfushorit të ri Leon Avdullahu, i cili vendosi ta përfaqësojë Kosovën në arenën ndërkombëtare. “Kosova dhe Zvicra janë miq, në futboll vendos loja”. I pyetur nëse Zvicra duhet të ketë frikë nga Kosova, Ademi u shpreh: “Zvicra nuk ka pse të frikësohet, as nga unë e as nga futbollit kosovar. Ne jemi miq të mirë, dhe nga miqtë nuk ka arsye të kesh frikë. Marrëdhëniet tona me Zvicrën janë shumë të mira. Por, në fund, në futboll vendos kush fiton në fushë – dhe ne të premtën do ta synojmë fitoren”. Lidhur me kalimin e Leon Avdullahut nga përfaqësuesja zvicerane te Kosova, Ademi ka theksuar: “Leon ka vendosur me zemër. Ai është edhe shumë i mençur dhe e pa projektin tonë si diçka që i përshatet. Por, mbi të gjitha, ai e ka ndier Kosovën si shtëpinë e tij. Bisedit me të dhe me familjen kanë zgjatur më shumë se një vit, por vendimi final ka qenë



vetëm i tij. Prindërit nuk kanë ushtruar presion, e kanë lënë të lirë”. “Asnjë faji ndaj Zvicrës, përkundrazi falënderim”. Ademi u pyet nëse ndihet keq për faktin që Zvicra investon në formimin e këtyre lojtarëve, e më pas ata zgjedhin Kosovën: “Ne do të jemi gjithmonë falënderues ndaj Zvicrës, sepse na ka pranuar si komunitet dhe ka ndihmuar shqiptarët në shumë drejtime. Futbollistët shqiptarë e kanë ngritur futbollin zviceran në një nivel tjetër, që nga Granit Xhaka e Xherdan Shaqiri. Në Superligën zvicerane shpesh luajnë pesë apo gjashtë lojtarë me origjinë shqiptare, dhe edhe në akademi ka një numër të madh. Ata zhvillohen aty, dhe ne gëzohemi kur më pas ndihmojnë edhe Kosovën”. Kryetari i FFK-së tha se Kosova ka nisur një projekt afatgjatë me futbollistë të rinj: “Ne kemi

grumbulluar shumë lojtarë të rinj nga 17 deri në 20 vjeç, që do të jenë shtylla e ekipit për dhjetë vitet e ardhshme. Synimi ynë është pjesëmarrja në Kampionatin Evropian. Leonin e shohim si lider të këtij brezi, madje mund të bëhet ‘Granit Xhaka i Kosovës’. Natyrisht është ende i ri dhe nuk duam t'i bëjmë shumë presion, por besojmë se do të zhvillohet shumë”. Ademi bëri me dije se mes federatave nuk ka mosmarrëveshje: “Ne nuk u ankuam kur Andi Zeqiri apo Uran Bislimi zgjodhën Zvicrën, edhe pse më parë ishin te Kosova. Vendimet e lojtarëve duhen respektuar. Edhe kur Xhaka e Shaqiri zgjodhën Zvicrën, ne i mbështetëm dhe jemi bërë tifozë të kombëtares zvicerane. E njëjta gjë vlen edhe sot”. Në fund, kreu i FFK-së konfirmoi se Kosova do të vazhdojë të mbështetet te lojtarët me origjinë të Kosovës që jetojnë në vende të ndryshme: “Sigurisht që diaspora në Zvicër është e madhe, prandaj duket sikur fokusohemi vetëm aty. Por kemi lojtarë edhe nga Gjermania, Franca apo Skandinavia. Dyert e Kosovës janë të hapura për të gjithë. Çdo lojtar ka mundësinë të na provojë, para se ta marrë vendimin final”.

Norrisi: Ta mbyllësh garën pa pikë kur garon për titull është shkatërruese, në Monza për fitore

MONZA, 4 SHTATOR - Çmimi i Madh i Holandës mund të ketë vendosur shumë në lidhje me titullin kampion për pilotë në Formula 1 për vitin 2025. Dalja nga gara e Lando Norrisit për shkak të një problemi teknik, e kombinuar me fitoren e Oscar Piastrit, i lejon pilotit australian të fitojë 25 pikë mbi shokun e tij të skuadrës. Tashmë dallimi në kampionat është 34 pikë. Anglezi po e humbet betejën në pistë me Piastrin, i cili vazhdimisht ka arritur ta mbajë makinën #4 në një distancë të sigurt. Gjithsesi, këtë fundjavë garohet sërish, këtë



herë në Monza, në tempullin e shpejtësisë, aty ku Norrisi shpreson ta rikuperojë terren. “Kam pilotuar mirë, kam pasur një garë të mirë, kam menaxhuar mirë gomat dhe gjithmonë kam qëndruar brenda një difference të

mirë me Oscar në Holandë. Nëse do të kishte pasur një mundësi do të kisha dueluar për fitoren. Do të kisha qenë i lumtur edhe me vendin e dytë, por në fund gjërat shkuan keq”, ka shtuar Norrisi. “Nuk mendoj se gara për titull është mbyllur, por është zhgënjyese të dalësh nga gara me 0 pikë kur duelon për titull. Duhet ta mbaj kokën lart dhe të përqendrohem te gara e radhës në Monza, për të fituar e rikuperuar terren. Humba shumë pikë për shkak të një problemi në makinë. Tani po përqendrohem te Monza”, ka deklaruar Norrisi.

Arnoldi: Largimi nga Liverpooili ishte vendimi më i vështirë i jetës sime

TRENT ALEXANDER-Arnold ka folur hapur rreth vendimit të tij për t'u larguar nga klubi i fëmijërisë, Liverpool, pasi fitoi Ligën Premierë sezonin e kaluar. Mbrotjtësi anglez zgjodhi t'i ndiqte ëndrrat e tij dhe iu

bashkua Real Madridit këtë verë, teksa në një intervistë me gazetën spanjolle GQ, foli rreth vendimit. “Ishte një nga vendimet më të vështira të jetës sime”, ka thënë fillimisht Alexander-Arnold. “Liverpooli është shtëpia ime. Më

bëri ai që jam, por Real Madridi më dukej si hapi i duhur, në kohën e duhur. Është padyshim një sfidë, por është një sfidë që e mirëpres. ‘Bernabeu’ është një vend i shenjtë. Ndien peshën e fanellës, por pikërisht kjo gjë të

shtyn t'i japësh gjithçka. Sigurisht, trashëgimia (e Real Madridit) është e pamohueshme. Por, më shumë se kaq, ajo që më tërhoqi ishte ambicia dhe dëshira për ta provuar veten në një kontekst të ri”, ka thënë ai. “Po,

mendoj se është një transformim personal si dhe profesional. Të zhvendosesh në një vend të ri, të mësosh një kulturë të re, të shtyn përpara si person. Është më shumë sesa futboll”, ka shtuar mbrotjtësi anglez.

SHKURT

Napoli synon ta ‘blindojë’ me kontratë të re Rrahmanin

Kapiteni i Kosovës, Amir Rrahmani, është shumë afër nënshkrimit të një kontrate të re me Napolin. Sipas raportimeve të “Spazionapoli.it”, mbrotjtësi 31-vjeçar do ta vazhdojë bashkëpunimin me klubin napolitan deri në vitin 2029, duke zgjatur marrëveshjen që skadon në qershor të vitit 2027. Rrahmani përfiton aktualisht 3 milionë euro në vit te Napoli dhe, pavarësisht interesimit të madh, ai ka zgjedhur të qëndrojë në “Diego Armando Maradona”. Ai refuzoi dy oferta nga klube të Ligës Premierë si dhe një ofertë të majme financiare nga Arabia Saudite. Mbrotjtësi kosovar iu bashkua Napolit në vitin 2020 dhe deri tani ka fituar tituj me skuadrën italiane, duke u bërë një prej shtyllave kryesore të mbrotjtjes. Rrahmani është aktualisht me Kombëtaren e Kosovës për dy sfidat e para në kualifikimet e Kupës së Botës 2026: përballë Zvicrës të premtën në Basel dhe ndaj Suedisë më 8 shtator në Prishtinë.

Lewandowski refuzoi ofertat marramendëse nga dy klube saudite

Robert Lewandowski ka refuzuar dy oferta të majme transferimi nga klubet saudite Al Hilal dhe Al Nassr këtë verë duke qëndruar te Barcelona. Sipas mediumit “365scoresarabic”, sulmuesi polak u kontaktua përmes agentit të tij, Pini Zahavi, por vendosi të mos largohej, pavarësisht prej interesimit serioz dhe kontratës marramendëse prej 100 milionë eurosh në sezon. Lewandowski pati sezonin e tij më të mirë në La Liga në vitin 2024/25, me 27 gola në kampionat dhe 42 gjithsej, vetëm pak prapa Kylian Mbappe në garën për “Këpucën e Artë”. Ai mbetet i përkushtuar ndaj Barcelonës dhe dëshiron të fitojë më shumë trofe në sezonin e katërt dhe të fundit të kontratës së tij, ndërsa synon ta udhëheqë edhe Poloninë drejt Kupës së Botës 2026.

Onana mund të transferohet në Arabinë Saudite

Portieri kamerunas Andre Onana mund të largohet nga Manchester Unitedi ditët në vijim. 29-vjeçari raportohet se është shënjestruar nga disa klube në Ligën Profesionale Saudite. Ndaj “Djajtë e Kuq” po e shqyrtojnë mundësinë e largimit të tij, veçanërisht duke pasur parasysh vendimin e trajnerit Ruben Amorim për t'i besuar portën Senne Lammers, i blerë nga Antwerpi në ditët e fundit të merkatos. Kontrata e portierit kamerunas skadon në vitin 2028, me një opsion rinovimi për një vit tjetër, por kjo gjë nuk ka për të ndodhur. Duket qartë se klubi anglez nuk i beson më dhe dëshiron ta largojë. Onana nuk ka luajtur në asnjë ndeshje në Premierë Ligë këtë sezon. Fenerbahçe thuhet se është e interesuar për Onanan, ku ai mund të shërbejë si zëvendësues i Edersonit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania kompanisë “Elektro System” shpk, Pejë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, – për Parkun Solar me kapacitet 0.57 MWp, në Z.K. Prekallë, Istog.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 22.10.2025 në ora 09:00 në Objektivin e Shtëpisë së Kulturës, Istog, Adresa: Rr. “Skënderbeu”, do të organizohet debat publik nga Kompania kompanisë “Elektro System” shpk, Pejë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=GbKcoccSWx39F3e8QF7PsAkCM3bvK6.1>

Meeting ID: 454 934 4495
Passcode: Aela2019.

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë kompanisë “Elektro System” shpk, Pejë, për Pëlqim Mjedisor, – për Parkun Solar me kapacitet 0.57 MWp, në Z.K. Prekallë, Istog.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

NJOFTIM MBI ZVOGËLIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË "Capital Alliance Investment Advisory" L.L.C.

Në përputhje me kërkesat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare në Kosovë dhe të Marreveshjes dhe Statutit të Shoqërisë, të plotësuar dhe ndryshuar, Kuvendi i Aksionareve të shoqërisë “Capital Alliance Investment Advisory” L.L.C., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me numër unik identifikues 811300607 (“Shoqëria”) ka nxjerr:

VENDIM PËR ZVOGËLIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË
me datë 27.08..2025

Kapitali i shoqërisë zvogëlohet nga vlera e regjistruar **1,554,387.62 Euro në 61,850.00 Euro**

Të gjithë Kreditorët e Shoqërisë kanë të drejtën që në afatin 21 ditor nga dita e publikimit të këtij njoftimi në shtypin ditë të drejtohen Shoqërisë me kërkesë për siguri shtesë ose kërkesë për mos-zvogëlim të kapitalit. Kërkesat i drejtohen Shoqërisë përmes postës së rregullt në adresën:

“Capital Alliance Investment Advisory” L.L.C., me seli në Prishtinë, Rr. Anton Çetta nr.23



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Gadaf Fetahu shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën QK “11 Marsi” Prizren.

- Halis Ademi shpall të pavlefshme diplomën QK “11 Marsi” Prizren.

- Qendresa Kastrati shpall të pavlefshme dëftesën e kl V- IX shfmu “Brigada 125” Medvec

- Burim Buza shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, pent-house. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli i vendit të punës: Zyrtar/e i/e Lartë për Rregullativë dhe Standardizim
Grada: P05
Kohëzgjatja e punësimit: me afat të pacaktuar
Departamenti: Departamenti i Licencimit dhe Standardizimit
Divizioni: Divizioni për Rregullativë dhe Standardizim
I raporton: Udhëheqësit të Divizionit për Rregullativë dhe Standardizim

Detyrat dhe Përgjegjësitë Kryesore:

- Harton, harmonizon dhe interpreton kornizën ligjore dhe rregullative për institucionet financiare në vazhdimësi dhe në mënyrë korrekte;
- Rishikon dhe përmirëson vazhdimisht kornizën rregullative për institucionet financiare, për të qenë në harmoni të plotë me standardet ndërkombëtare;
- Ndihmon në procesin e përmirësimit të vazhdueshëm metodologjik dhe praktik të modelit të mbikëqyrjes së institucioneve financiare në funksion të standardizimit të tij;
- Jep opinione sipas kërkesave të ndryshme që vijnë nga institucionet financiare lidhur me zbatimin e kuadrit rregullativ brenda kompetencave dhe funksionit të Departamentit;
- Ndihmon në hartimin akteve nënligjore, udhëzuesve dhe metodologjisë, në funksion të përmbushjes së objektivave për rimëkëmbjen dhe përmbylljen e bankave;
- Hulumton dhe analizon Direktivat e BE-së si dhe standardeve e pranuar ndërkombëtare (Basel, ICP e të ngjashme), për mbikëqyrje financiare;
- Përcjell zhvillimet dhe praktikat ndërkombëtare të mbikëqyrjes financiare, adaptimi i të cilave është kërkesë për autoritetet mbikëqyrëse të shteteve anëtare të BE-së;
- Përpilon metodologji për implementimin e Standardeve të pranuar ndërkombëtare dhe analizon ndikimin e këtyre standardeve në sistemin financiar të vendit;
- Mbështet bashkëpunimin e nevojshëm me të gjitha palët relevante të Departamentit;
- Përgatit raporte mbi kornizat ligjore dhe rregullative të aplikueshme të mbikëqyrjes financiare;
- Përgatit raportet e rregullta dhe të posaçme (ad-hoc raporteve) për çështjet që lidhen me Divizionin për Rregullativë dhe Standardizim;
- Kryen të gjitha detyrat tjera të cilat i caktohen nga Udhëheqësi i Divizionit dhe Drejtori i Departamentit.

Njohuritë akademike dhe profesionale të kërkuara:

- Diplomë universitare në fushën e drejtësisë/juridike;
- Preferohet të ketë certifikime nga fushat e përmendura më lartë;
- Njohja e gjuhës angleze është përparësi.

Përvoja profesionale e kërkuar:

- Të ketë së paku tre (3) vite përvojë pune profesionale në sektor financiar ose përvojë në fushën e cila ndërlidhet me përgjegjësitë e Divizionit për Rregullativë dhe Standardizim.

Kërkesat e posaçme:

- Aftësi analitike të gjykitimit për të vlerësuar dhe zbatuar legjislacionin ne fuqi dhe për të rekomanduar veprime të mëtutjeshme;
- Aftësi për të krijuar dhe mirëmbajtur marrëdhënie të mira profesionale me kolegët si dhe me palët e jashtme;
- Aftësi për të punuar nën presion dhe për të përmbushur afatet e caktuara kohore;
- Aftësi për zgjidhjen e problemeve sipas prioriteteve;
- Njohuri të shkëlqyera në përdorimin e sistemeve kompjuterike, MS Office e të ngjashme;
- Shkathtësi të mira komunikimi dhe prezantimi;
- Person me etikë të lartë dhe i aftë në ruajtjen e fshehtësisë profesionale;
- Vëmendje në detaje, në formulime të qarta dhe saktësi;
- Vetëiniciativë dhe gatishmëri për punë ekipore;
- Të ketë njohuri të rrjedhshme të gjuhës shqipe dhe/ose serbe në të folur dhe të shkruar.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë, përshtatshmëria me pozitën, planin dhe objektivat tuaja;
- Dëshmi mbi përvojën e punës (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale).
- Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti) për periudhën përkatëse, apo vërtetimin tatimor nga Administrata e Tatimore (ATK) kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës;

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim 22 shtator 2025.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.



OGLAS ZA KONKURS ZA POSAO

Naziv posla: Viši službenik za regulativu i standardizaciju
Rang: SU05
Trajanje radnog odnosa: neodređeno
Odeljenje: Odeljenje za licenciranje i standardizaciju
Odsek: Sektor za regulativu i standardizaciju
Izveštaji: Rukovodilac Sektora za regulativu i standardizaciju

Glavne dužnosti i odgovornosti:

- Kontinuirano i korektno izrađuje, usklađuje i tumači pravni i regulatorni okvir za finansijske institucije;
- Kontinuirano razmatra i unapređuje regulatorni okvir za finansijske institucije, kako bi bio u potpunosti u skladu sa međunarodnim standardima;
- Pomaže u procesu kontinuiranog metodološkog i praktičnog unapređenja modela supervizije finansijskih institucija u cilju njegove standardizacije;
- Daje mišljenja o različitim zahtevima finansijskih institucija u vezi sa primenom regulatornog okvira u nadležnostima i funkcijama Odeljenja;
- Pomaže u izradi podzakonskih akata, smernica i metodologije, kako bi se ispunili ciljevi oporavka i zatvaranja banaka;
- Istražuje i analizira direktive EU i međunarodno prihvaćene standarde (Basel, ICP, itd.) za finansijski nadzor;
- Prati međunarodna dešavanja i prakse finansijskog nadzora, čije je usvajanje uslov za nadzorne organe država članica EU;
- Sastavlja metodologije za implementaciju međunarodno prihvaćenih standarda i analizira uticaj ovih standarda na finansijski sistem zemlje;
- Podržava neophodnu saradnju sa svim relevantnim stranama Odeljenja;
- Priprema izveštaje o važećim zakonskim i regulatornim okvirima finansijskog nadzora;
- Priprema redovne i specijalne izveštaje (ad hok izveštaje) o pitanjima u vezi sa Sektorom za regulativu i standardizaciju;
- Obavlja sve ostale poslove koje dodeljuje šef Odseka i direktor Odeljenja.

Potrebna akademska i stručna znanja:

- Visoka stručna sprema u oblasti prava/pravnih studija;
- Poželjni su sertifikati u gore navedenim oblastima;
- Znanje engleskog jezika je prednost.

Potrebno radno iskustvo:

- Najmanje tri (3) godine profesionalnog radnog iskustva u finansijskom sektoru ili iskustvo u oblasti koja se odnosi na odgovornosti Odeljenja za regulativu i standardizaciju.

Posebni zahtevi:

- Analitičke veštine procene za procenu i implementaciju važećih zakona i preporuke za dalje akcije;
- Sposobnost uspostavljanja i održavanja dobrih profesionalnih odnosa sa kolegama, kao i spoljnim stranama;
- Sposobnost rada pod pritiskom i ispunjavanja postavljenih rokova;
- Sposobnost rešavanja problema u skladu sa prioritetima;
- Odlično poznavanje korišćenja računarskih sistema, MS Office i sl.;
- Dobre komunikacione i prezentacione veštine;
- Osoba sa visokom etikom i vešt u održavanju profesionalne poverljivosti;
- Pažnja na detalje, jasne formulacije i tačnost;
- Samoinicijativa i spremnost za rad u timu;
- Tečno poznavanje albanskog i/ili srpskog jezika u govoru i pisanju.

Svi kandidati moraju dostaviti sledeće dokumente:

- Zvanični CBK obrazac za prijavu;
- Propratno pismo (motivacija) naglašavajući vaš interes za ovu poziciju, podobnost za poziciju, vaš plan i ciljeve;
- Dokaz o radnom iskustvu (kopije ugovora ili potvrda od poslodavca ili drugih relevantnih dokumenata koji služe za dokazivanje radnog položaja i radnog iskustva, ne dovodeći u pitanje relevantne akte o zaštiti ličnih podataka).
- Izveštaj Kosovskog penzionog fonda (Trust) za odgovarajući period, ili poresko uverenje Poreske uprave (PUK) kada izveštaj Fonda nije zakonski primenljiv;
- Kopije diploma, dok diplome stečene izvan Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate/nostrifikovane od strane MONT;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koja služi za dokazivanje državljanstva Kosova;

Postupak prijave:

- Rok za prijavu 22 septembar 2025.
- Prijava se može izvršiti online (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvaničnog sajta CBK. Ostali obrasci za prijavu neće biti razmatrani.



SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli i vendit të punës: Zyrtar/e për Rregullativë dhe Standardizim
Grada: P06
Kohëzgjatja e punësimit: me afat të pacaktuar
Departamenti: Departamenti i Licencimit dhe Standardizimit
Divizioni: Divizioni për Rregullativë dhe Standardizim
I raporton: Udhëheqësit të Divizionit për Rregullativë dhe Standardizim

Detyrat dhe Përgjegjësitë Kryesore:

- Ndihmon në hartimin, harmonizimin dhe interpretimin e kornizës ligjore dhe rregullative për institucionet financiare në vazhdimësi dhe në mënyrë korrekte;
- Merr pjesë në procesin e rishikimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të kornizës rregullative për institucionet financiare, për të qenë në harmoni të plotë me standardet ndërkombëtare;
- Ndihmon në procesin e përmirësimit të vazhdueshëm metodologjik dhe praktik të modelit të mbikëqyrjes së institucioneve financiare në funksion të standardizimit të tij;
- Përgatit opinione sipas kërkesave të ndryshme që vijnë nga institucionet financiare lidhur me zbatimin e kuadrit rregullativ brenda kompetencave dhe funksionit të Departamentit;
- Ndihmon në hartimin akteve nënligjore, udhëzuesve dhe metodologjisë, në funksion të përmbushjes së objektivave për rimëkëmbjen dhe përmbylljen e bankave;
- Hulumton dhe mbledh të dhëna për Direktivat e BE-së si dhe standardeve e pranuar ndërkombëtare (Basel, ICP e të ngjashme), për mbikëqyrje financiare;
- Përcjell zhvillimet dhe praktikat ndërkombëtare të mbikëqyrjes financiare, adaptimi i të cilave është kërkesë për autoritetet mbikëqyrëse të shteteve anëtare të BE-së;
- Mbështet bashkëpunimin e nevojshëm me të gjitha palët relevante të Departamentit;
- Përgatit raporte mbi kornizat ligjore dhe rregullative të aplikueshme të mbikëqyrjes financiare;
- Përgatit raportet e rregullta dhe të posaçme (ad-hoc raporteve) për çështjet që lidhen me Divizionin për Rregullativë dhe Standardizim;
- Bashkëpunon me kolegët dhe me palët relevante për realizimin e detyrave të Divizionit;
- Kryen të gjitha detyrat tjera të cilat i caktohen nga Udhëheqësi i Divizionit dhe Drejtori i Departamentit.

Njohuritë akademike dhe profesionale të kërkuara:

- Diplomë universitare në fushën e ekonomisë apo drejtësisë;
- Preferohet të ketë certifikime nga fushat e përmendura më lartë;
- Njohja e gjuhës angleze është përparësi.

Përvoja profesionale e kërkuar:

- Të ketë së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në sektor financiar ose përvojë në fushën e cila ndërlidhet me përgjegjësitë e Divizionit për Rregullativë dhe Standardizim.

Kërkesat e posaçme:

- Aftësi analitike të gjykimit për të vlerësuar dhe zbatuar legjislacionin në fuqi dhe për të rekomanduar veprime të mëtutjeshme;
- Aftësi për të krijuar dhe mirëmbajtur marrëdhënie të mira profesionale me kolegët si dhe me palët e jashtme;
- Aftësi për të punuar nën presion dhe për të përmbushur afatet e caktuara kohore;
- Aftësi për zgjidhjen e problemeve sipas prioriteteve;
- Njohuri të shkëlqyera në përdorimin e sistemeve kompjuterike, MS Office e të ngjashme;
- Shkathësi të mira komunikimi dhe prezantimi;
- Person me etikë të lartë dhe i aftë në ruajtjen e fshehtësisë profesionale;
- Vëmendje në detaje, në formulime të qarta dhe saktësi;
- Vetëiniciativë dhe gatishmëri për punë ekipore;
- Të ketë njohuri të rrjedhshme të gjuhës shqipe dhe/ose serbe në të folur dhe të shkruar.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë, përshtatshmëria me pozitën, planin dhe objektivat tuaja;
- Dëshmi mbi përvojën e punës (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale).
- Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti) për periudhën përkatëse, apo vërtetimin tatimor nga Administrata e Tatimore (ATK) kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës;

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim 22 shtator 2025.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.



OGLAS ZA KONKURS ZA POSAO

Naziv posla: Službenik za regulativu i standardizaciju
Rang: SU06
Trajanje radnog odnosa: neodređeno
Odeljenje: Odeljenje za licenciranje i standardizaciju
Odsek: Sektor za regulativu i standardizaciju
Izveštaji: Rukovodilac Sektora za regulativu i standardizaciju

Glavne dužnosti i odgovornosti:

- Pomaže u izradi, usaglašavanju i tumačenju pravnog i regulatornog okvira za finansijske institucije na kontinuiran i ispravan način;
- Učestvuje u procesu kontinuiranog preispitivanja i unapređenja regulatornog okvira za finansijske institucije, kako bi bili u potpunosti usklađeni sa međunarodnim standardima;
- Pomaže u procesu kontinuiranog metodološkog i praktičnog unapređenja modela supervizije finansijskih institucija u cilju njegove standardizacije;
- Priprema mišljenja po različitim zahtevima finansijskih institucija u vezi sa primenom regulatornog okvira u nadležnostima i funkcijama Odeljenja;
- Pomaže u izradi podzakonskih akata, smernica i metodologije, kako bi se ispunili ciljevi oporavka i zatvaranja banaka;
- Istražuje i prikuplja podatke o direktivama EU i međunarodno prihvaćenim standardima (Bazel, ICP i sl.) za potrebe finansijskog nadzora;
- Prati međunarodna dešavanja i prakse finansijskog nadzora, čije je usvajanje uslov za nadzorne organe država članica EU;
- podržava neophodnu saradnju sa svim relevantnim stranama Odeljenja;
- Priprema izveštaje o važećim zakonskim i regulatornim okvirima finansijskog nadzora;
- Priprema redovne i specijalne izveštaje (ad hok izveštaje) o pitanjima u vezi sa Sektorom za regulativu i standardizaciju;
- Sarađuje sa kolegama i relevantnim stranama na obavljanju zadataka Odseka;
- Obavlja sve ostale poslove koje dodeljuje šef Odseka i direktor Odeljenja.

Potrebna akademska i stručna znanja:

- Visoka stručna sprema u oblasti ekonomije ili prava;
- Poželjni su sertifikati u gore navedenim oblastima;
- Znanje engleskog jezika je prednost.

Potrebno radno iskustvo:

- Najmanje dve (2) godine profesionalnog radnog iskustva u finansijskom sektoru ili iskustvo u oblasti koja se odnosi na odgovornosti Odeljenja za regulativu i standardizaciju.

Posebni zahtevi:

- Analitičke veštine procene za procenu i implementaciju važećih zakona i preporučiti dalje akcije;
- Sposobnost uspostavljanja i održavanja dobrih profesionalnih odnosa sa kolegama, kao i spoljnim stranama;
- Sposobnost rada pod pritiskom i ispunjavanja postavljenih rokova;
- Sposobnost rešavanja problema u skladu sa prioritetima;
- Odlično poznavanje korišćenja računarskih sistema, MS Office i sl.;
- Dobre komunikacione i prezentacione veštine;
- Osoba sa visokom etikom i vešta u održavanju profesionalne poverljivosti;
- Pažnja na detalje, dobre komunikacione veštine i tačnost;
- Samoinicijativa i spremnost za rad u timu;
- Tečno poznavanje albanskog i/ili srpskog jezika u govoru i pisanju.

Svi kandidati moraju dostaviti sledeće dokumente:

- Zvanični CBK obrazac za prijavu;
- Propratno pismo (motivacija) naglašavajući vaš interes za ovu poziciju, podobnost za poziciju, vaš plan i ciljeve;
- Dokaz o radnom iskustvu (kopije ugovora ili potvrda od poslodavca ili drugih relevantnih dokumenata koji služe za dokazivanje radnog položaja i radnog iskustva, ne dovodeći u pitanje relevantne akte o zaštiti ličnih podataka).
- Izveštaj Kosovskog penzionog fonda (Trust) za odgovarajući period, ili poresko uverenje Poreske uprave (PUK) kada izveštaj Fonda nije zakonski primenljiv;
- Kopije diploma, dok diplome stečene izvan Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate/nostrifikovane od strane MEST;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koja služi za dokazivanje državljanstva Kosova;

Postupak prijave:

- Rok za prijavu 22 septembar 2025.
- Prijava se može izvršiti online (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvaničnog sajta CBK. Ostali obrasci za prijavu neće biti razmatrani.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

